

1 E enjte, 9 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.01

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, mund të thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, është
10 çështja KSC-BC-2023-06 [sipas përkthimit], Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Përpara se të fillojmë, kam një pyetje për Mbrojtjen e
15 Thaçit lidhur me deklaratat e pranuar në bazë të rregullës
16 143(2) (c).

17 Dua të sigurohem që e kuptoj atë që thatë dje kur u
18 pranua. Me këtë duhet të kuptojmë se sugjeroni që kur një
19 deklaratë pranohet në përputhje me këtë rregull, ne mund ta
20 përdorim për vërtetësinë e atyre për të cilat u pyet
21 dëshmitari gjatë dëshmisë së tij të drejtpërdrejtë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, ashtu është. Për aq sa ato nuk
23 përputhen me ato që janë, dëshmitari, që, në Gjykatë. Ndryshe,
24 kur nuk pyetet, s'kemi ç'të diskutojmë për mospërputhje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po

1 përdorni autoritetin tuaj dhe për këtë duhet të na jepni në
2 një, ta paraqisni deklaratën në 20 nëntor.

3 Z. MISETIC: [Nuk ka përkthim]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjja e
5 ZPS-së duhet të jetë brenda pesë ditësh.

6 Në rregull. E di që z. Krasniqi është i pranishëm përmes
7 videolidhjes, të pandehurit e tjerë janë të gjithë këtu të
8 pranishëm sot.

9 Do të dëgjojmë dëshmitarin e Prokurorisë W04043.

10 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin.

11 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
13 rrijë në këmbë dëshmitari, ju lutem.

14 Mirëmëngjes, dëshmitar. Më dëgjoni?

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, po. Ju dëgjoj.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani
17 Sekretarja do të japë tekstin e deklaratës solemne që duhet ta
18 bëni brenda rregullës 141(2). Shikojeni dokumentin dhe lexoni
19 me zë të lartë.

20 Lexojeni.

21 DËSHMITARI: [Përkthim]

22 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe
23 përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them
24 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk
25 do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

1 DËSHMITARI: W04043

2 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthyesit]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni tani,
4 dëshmitar.

5 Sot do të fillojmë dëshminë tuaj, Dëshmitar, që pritet të
6 zgjasë gjatë gjithë ditës së sotme. Së pari do t'ju pyesë
7 Prokuroria, Mbrojtësi i Viktimave nuk do t'ju bëjë pyetje,
8 pasi të mbarojë Prokuroria do t'ju bëjë pyetje Mbrojtja.
9 Pastaj, edhe anëtarë të Trupit Gjykes mund t'ju bëjnë pyetje.

10 Prokuroria vlerëson se i duhet rreth një orë për t'ju
11 bërë pyetje. Mbrojtja, dy orë e gjysmë. Lidhur me vlerësimet,
12 shpresojmë se të dy palët do ta përdorin kohën me kujdes dhe
13 ne do të lejojmë pyetje të mëtejshme nëse plotësojmë kushtet
14 nga palët.

15 Përgjigjuni [sipas përkthimit], Dëshmitar, që pyetjeve
16 t'u përgjigjeni shkurt me fjali të shkurtra. Nëse nuk e
17 kuptoni një fjali, kërkoni t'jua përsërisim apo u thoni që nuk
18 e kuptoj, dhe ata do t'jua sqarojnë.

19 Gjithashtu, vini në dukje se ku i mbështesni pra ato që
20 do të thoni për të cilat do t'ju pyesin.

21 Në rast se ZPS-ja ju pyet për të vërtetuar disa
22 ndryshime, ndonjë ndryshim që mund ta keni bërë, duhet të
23 konfirmoni që ato ndryshime pasqyrojnë me saktësi deklaratën
24 tuaj.

25 Gjithashtu, flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë

1 sekonda përpara se t'i përgjigjeni. Gjithashtu flisni me
2 ngadalë që t'ju ndjekin përkthyesit.

3 Gjatë kohës që jepni dëshmi, këtu nuk lejoheni që këto
4 dëshmi ta diskutoni me njeri jashtë sallës së gjyqit. Nëse
5 ndonjë person ju bën pyetje jashtë sallës së gjyqit lidhur me
6 dëshminë tuaj, na vini në dijeni.

7 Mos flisni nëse unë jua bëj me shenjë, ju them të mos
8 flisni apo në qoftë se unë ngre dorën. Këto tregojnë se duhet
9 t'u jap udhëzime të tjera.

10 Nëse keni nevojë për pushim, na thoni dhe do t'jua
11 plotësojmë dëshirën.

12 Do të fillojmë me pyetjet e drejtpërdrejta të
13 Prokurorisë.

14 Prokuroria është në anën tuaj të majtë.

15 Prokuror, keni fjalën.

16 Pyetje nga z. Boyle:

17 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit shumë, i nderuar
18 Gjykatës.

19 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

20 PË. Mirëmëngjes.

21 PY. Unë do të prezantohem. Jam Andrew Boyle, edhe pse ne jemi
22 takuar, punoj në Zyrën e Prokurorisë së Posaçme. Do t'ju bëj
23 disa pyetje gjatë orës që vjen.

24 Siç jua shpjegova gjatë përgatitjeve para ca ditësh, në
25 vend që t'ju bëj pyetje për çdo çështje, për të cilën mund të

1 keni informacion, disa nga deklaratat tuaja të mëparshme që e
2 përmbajnë një informacion të tillë, mund t'i paraqesim si
3 prova materiale. Për ta bërë këtë janë disa masa, disa hapa
4 proceduralë që duhet t'i ndjekim, të cilat unë do t'i përdor
5 pasi të vërtetojmë se cili jeni.

6 Si ju quajnë, Dëshmitar?

7 PË. Dragan Ivanisevic.

8 PY. Kur keni lindur?

9 PË. Në 12 nëntor 1962.

10 PY. Çfarë kombësie keni?

11 PË. Serb.

12 Z. BOYLE: [Përkthim] Sekretare, dua që në ekran të
13 paraqesim provën materiale 106336-TR-ET Pjesa 1 RED2, kurse në
14 serbisht është 106336-TR-ST Pjesa 1 RED.

15 PY. [Nuk ka përkthim]

16 PË. [Nuk ka përkthim]

17 PY. [Nuk ka përkthim]

18 PË. [Nuk ka përkthim]

19 PY. [Nuk ka përkthim]

20 PË. [Nuk ka përkthim]

21 PY. A e mbani mend që në fakt bëtë disa sqarime lidhur me
22 këtë deklaratë të mëparshme?

23 PË. Po, e mbaj mend.

24 PY. E mbani mend që këto sqarime, korrigjime janë përfshirë
25 në një dokument që ua lexuan në fund?

1 PË. Po.

2 PY. Në varësi të këtyre korrigjimeve, informacioni që jepni
3 aty a është i vërtetë dhe i saktë me aq sa dini dhe kujtoni?

4 PË. Po. Po, është e vërtetë.

5 PY. Pas korrigjimeve që keni bërë që paraqiten në këtë
6 dokument, deklarata që përmenda sot a pasqyron drejt lidhur me
7 ato që do të thoni kur t'ju bëjmë pyetje për ngjarjet që kanë
8 ndodhur?

9 PË. Po.

10 Z. BOYLE: [Nuk ka përkthim]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
12 kundërshtim?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Deklaratat e
15 mëparshme bashkë me provat e lidhura me to që janë SPOE0341540
16 dhe 106334 deri në 106335, dhe dokumenti i përgatitur do të
17 pranohen, do t'u jepet një numër.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklaratat do të kenë
19 numrin P694.1 për Pjesën 1, P694.2 për Pjesën 2, dhe P643 për
20 Pjesën 3.

21 Provat e lidhura me to SPOE00341540 do të jetë prova
22 materiale P695.

23 Dokumenti 106334 deri në 106335 do të jetë prova
24 materiale P696.

25 Dhe, dokumenti përgatitor 106792 deri në 106795 do të

1 jetë prova materiale P697.

2 Dhe shoh që të gjitha janë të shënuara si konfidenciale.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të doja të
4 pyesja nëse mendoni të jenë të tilla. A mund të bëhen publike?

5 Z. BOYLE: [Përkthim] Po.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja, ka
7 ndonjë kundërshtim?

8 Jo. Atëherë këto dokumente, siç i numëroi Sekretarja, do
9 të klasifikohen si publike.

10 Mund të vazhdoni.

11 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit.

12 Në 3 nëntor 2023, ZPS-ja qarkulloi një përmbledhje të
13 propozuar të këtij dëshmitari që është pranuar. Nuk kemi marrë
14 ndonjë kundërshtim nga palët për këtë përmbledhje. Kështu që
15 përpara se të filloj të bëj pyetje shtesë, do të jap një
16 përmbledhje të dëshmisë së dëshmitarit që e keni dhe në
17 dokumente.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
19 vazhdoni.

20 Z. BOYLE: [Përkthim] Dragan Ivanisevic po vinte në shtëpi
21 nga Prishtina me makinë mbrëmjen e 9 shkurtit 1999, kur e
22 rrëmbyen disa burra të armatosur me uniformë të UÇK-së.

23 Brenda një ore apo diçka e tillë, UÇK-ja e transportoi
24 dëshmitarin në vende, nga një vend në tjetrin, me një Lada të
25 bardhë.

1 Rrëmbimi i dëshmitarit përkoi me rrëmbimin nga UÇK-ja të
2 Veljko Markovic. Dëshmitari e pa Markovic atë ditë disa herë
3 edhe kur i mbajtën bashkë në bagazhin, mbrapa një makine Lada,
4 duke i çuar nga një vend tek tjetri.

5 Gjatë kësaj kohe, z. Markovic i tha dëshmitarit, ndër të
6 tjera, se ishte polic, por se do t'ju thonte kidnapuesve se
7 punonte në hekurudhë. Z. Markovic dhe dëshmitari arritën që ta
8 hapin bagazhin dhe dëshmitari iku, ndërsa Markovic vazhdoi që
9 të ishte nën, i ndaluar nga UÇK-ja.

10 Pasi iku, dëshmitari mësoi nga të tjerë, përfshirë dhe
11 nga familja e z. Markovic se Markovic ishte parë për herë të
12 fundit po atë ditë që dëshmitari ishte rrëmbyer, kur, duke
13 ngarë një makinë Lada të bardhë. Ai mësoi se z. Markovic
14 punonte si polic për hekurudhën, i njëjti informacion që i
15 kishte treguar vetë z. Markovic kur i mbanin bashkë në
16 bagazhin e një makine Lada. Gjithashtu, dëshmitari mësoi se z.
17 Markovic nuk ishte kthyer në shtëpi.

18 PY. Z. Ivanisevic, në deklaratën tuaj ju thoni që ju kanë
19 ndaluar UÇK-ja rreth orës 6 të pasdites në 9 shkurt 1999, në
20 afërsi të Novoselës. E keni mësuar ndonjëherë se kur dhe në
21 ç'kohë Veljko Markovic dhe Nebojsa janë parë për herë të
22 fundit?

23 PË. Djuric, Nebojsa Djuric. Ata u panë për herë të fundit në
24 një mbrëmje, ishin në kafene dhe kur u larguan nga kafeneja
25 rreth orës 16.00-17.00, kafeneja ishte në Fushë Kosovë, pra u

1 larguan në këtë kohë në 16.00-17.00, ishte hera e parë që janë
2 parë.

3 PY. A mund të na thoni se në ç' datë mësuat që ata u larguan
4 nga kafeneja?

5 PË. Në 9 shkurt.

6 PY. Gjithashtu, thoni në deklaratat tuaja të pranuar si
7 prova, se Markovic dhe Djuric janë parë bashkë duke u larguar
8 nga kafeneja, që na e thatë këtë gjë. Kafeneja që përmendni,
9 ku ndodhej kjo?

10 PË. Në Fushë Kosovë.

11 Z. BOYLE: [Përkthim] Sekretare, ju lutem të shohim provën
12 SITF00319572, deri në 00326 [sipas përkthimit] dhe të kalojmë
13 në faqen SITF00319587. Por jo publikisht.

14 PY. Z. Ivanisevic, nuk e kemi në serbisht këtë dokument,
15 prandaj do t'jua përshkruaj atë që përmban që t'jua
16 përkthejnë.

17 Është një listë e personave të zhdukur lidhur me ngjarjet
18 në Kosovë, e prodhuar në mars 2001. Personat e zhdukur në këtë
19 listë janë vendosur në formë kronologjike në bazë të datës së
20 zhdukjes.

21 Z. BOYLE: [Përkthim] I lutem Sekretares ta zmadhojë pak
22 ato emrat e datës 9 shkurt 1999. Faleminderit.

23 PY. Z. Ivanisevic, janë vetëm dy shënime në këtë dokument që
24 mbajnë datën 9 shkurt 1999. Njëri prej tyre është për Djuric,
25 Nebojsa, Djuric, tjetri për Veljko Markovic. Dhe thotë që

1 secili prej tyre është parë për herë të fundit në Fushë

2 Kosovë. A është ky i njëjti vend që na thatë?

3 PË. Po.

4 PY. Në deklaratën tuaj të pranuar si provë, keni shpjeguar se

5 ju kanë ndaluar UÇK-ja në rrugë nga Prishtina në Vucitern,

6 pranë një qyteti të quajtur Novoselë. A mund të na thoni

7 përafërsisht, sa larg është Fushë Kosova nga vendi ku ju

8 ndaluan?

9 PË. Rreth 30 kilometra.

10 PY. Zotëri, ju na thatë se ju futën mbrapa në bagazhin e një

11 makine Golf, bashkë me z. Markovic. Nga ajo që patë, kur e

12 patë, a krijuat ndonjë ide se sa vjeç ishte?

13 PË. Ishte terr. Por do të thosha se ishte rreth moshës 35

14 vjeç, por nuk jam i sigurt sepse ishte vështirë të shikoje.

15 Por afërsisht do të thoja 35 vjeç.

16 PY. Në lidhje me dokumentin që vazhdon të jetë ende në ekran,

17 aty ka ditëlindjet e personave të zhdukur. Dhe për z. Markovic

18 datëlindja është 4 mars 1965. Kështu që i bie që të ketë qenë

19 33, gati 34 vjeç në kohën e ndalimit. A përputhet kjo me atë

20 që sapo na thatë lidhur me moshën e tij, sipas jush?

21 PË. Po, po, përputhet.

22 Z. BOYLE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që këtë

23 faqe të këtij dokumenti ta paraqes si provë materiale.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë

25 kundërshtim?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SITF00319572
3 deri në 00320326 do pranohet.

4 Është një faqe.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja me numër
6 00319587, do të ketë provën materiale, numrin si prova
7 materiale P698.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. BOYLE: [Përkthim]

10 PY. Zotëri, kur e patë z. Markovic për herë të parë në
11 bagazhin e makinës Golf, çfarë pamje kishte, si t'u duk kur e
12 pe?

13 PË. M'u duk mjaft i shqetësuar, i turbulluar, ishte i
14 përkulur përpara. Ishte i zhytur thellë në mendime. M'u duk se
15 ndihej i poshtëruar.

16 PY. A kishte, në atë kohë, kishte njeri pranë tij nga UÇK-ja
17 kur e patë për herë të parë?

18 PË. Po.

19 PY. A mund të na përshkruani personin apo personat që ishin
20 në afërsi, pranë tij, mbrapa, në vendet mbrapa në makinë, dhe
21 çfarë po bënin ata?

22 PË. Anëtarët e UÇK-së, anëtari i UÇK-së që e ruante, kishte
23 një armë automatike dhe i rrinte pranë, rrinte pranë në anën e
24 shoferit, ishte pranë makinës. Në anën e shoferit, por dera
25 ishte hapur. Dhe ai i kishte drejtuar armën atij. Dhe pastaj

1 ky ishte i ulur në ulësen e mbrapme të Golf-it.

2 PY. Z. Ivanisevic, në deklaratën tuaj thatë se në një moment
3 ju detyruan që të ngisni makinën tuaj Fiat, dhe se keni folur
4 me një prej anëtarëve të UÇK-së që ishte në makinë me ju. Ai
5 që ishte, ai burri që ishte në makinë me ju, ju përmendi
6 ndonjë rrëmbim tjetër, të personave të tjerë?

7 PË. Ndërsa unë po vozitja makinën time, ishte ulur pranë
8 meje. Dhe ndër pyetjet që ai më bëri, më tha që, në një moment
9 më tha, "Mos ki frikë. Do të ndodhi siç ndodhi me Miso
10 Begovic". Pastaj nga toni i zërit të tij m'u krijua përshtypje
11 se punët nuk vareshin prej tij. Pra, nuk e kishte ai në dorë
12 të vendoste.

13 PY. Kur ai përmendi Miso Begovic, ti e njihje kush ishte ai?

14 PË. [Nuk ka përkthim]

15 PY. Nuk mora përkthim, prandaj.

16 PËRKTHYESI: Është futur në kanalën e gabuar. Kërkon që ta
17 përsërisë pyetjen.

18 Z. BOYLE: [Përkthim]

19 PY. Zotëri, po jua përsëris pyetjen sepse pati një problem me
20 përkthimin.

21 A e keni ditur atëherë se kush ishte Miso Begovic kur jua
22 përmendi këtë emër?

23 PË. E njoh, e njihja. Flisja me të, fola me të kur shkuam në
24 Mitrovicë si refugjatë. E njihja si pamje, e njihja edhe
25 personalisht.

1 PY. Po personi i UÇK-së që ishte në makinën tuaj, kur ai
2 përmendi situatën e Mishel Begovic [sipas përkthimit], a dinit
3 ju në atë kohë ndonjë gjë lidhur me z. Begovic, apo çfarë mund
4 t'i kishte ndodhur atij?

5 PË. Po, e di. E dija që ai ishte liruar me ndihmën e OSBE-së,
6 tre ditë ose ndoshta katër apo pesë-gjashtë ditë pasi të ishte
7 rrëmbyer. Kjo ishte dhe në televizion.

8 PY. A dinit gjë ju se ku ishte ndaluar ai, apo ku ishte
9 liruar më pas?

10 PË. Nga çfarë tha ai më vonë, kur u takuam, ajo çfarë m'u
11 krijua mua si përshtypje është që nuk e dinte se ku ishte, se
12 ku ishte ndaluar. Vetëm se kur e kishin liruar e kishin sjellë
13 diku afër fshatit të vet, diku afër Çiçavicës.

14 PY. A dije ti ndonjë gjë lidhur me personin ose personat që e
15 kishin rrëmbyer atë?

16 PË. Po, ai tha që i kishin marrë disa burra nga UÇK-ja, madje
17 edhe e njihte dikë që e kishte marrë atë në pyetje, në bazën e
18 UÇK-së, nga Vushtria. Nuk ma ka përmendur emrin, ndoshta dhe
19 ma ka përmendur, por mua nuk më kujtohet tani se si quhej ai
20 person.

21 PY. Miso, është nofka për një emër tjetër, e dini, apo jo?

22 PË. Miso, duhet të jetë ndonjë shkurtim emri ose një nofkë.
23 neve e quajmë dikë, ose i drejtohem dikush si Miso në qoftë
24 se e ka emrin e plotë Milos ose Milovan, nuk e di emrin e
25 plotë. Njoh të birin, e njoh atë nga pamja, nga fytyra. Dhe më

1 pas e kam njohur më mirë. Njoh gjithashtu edhe të afërmit e
2 tij.

3 PY. Pak më herët, përmendët se ju ishte krijuar përshtypja se
4 individi që ishte në Fiat-in tuaj, ky personi i UÇK-së që
5 ishte së bashku me ju në makinën tuaj, në Fiat-in tuaj, thatë
6 që ju krijua përshtypja që fati juaj nuk ishte në dorën e tij,
7 nuk varej prej tij. A mund të na shpjegoni ju lutem çfarë doni
8 të thoni me këtë?

9 PË. Ndërkohë që po vozisja makinën, ai më pyeti si quhesh dhe
10 çfarë pune bëja. Ndër të tjera në një pikë ai më dha një
11 cigare. Në fillim i thashë që nuk pija duhan, dhe më pas i
12 thashë, "Mirë, në rregull po e marr një cigare". Ndërmjet
13 gjërave të tjera që më pyeti ai më tha gjithashtu, dhe e
14 vërteta është që mund ta shikoja që ai nuk ishte rehat. Ai më
15 pyeti ndër të tjera lidhur me kushëririn tim, kështu që m'u
16 krijua përshtypja që kishin punuar diku bashkë, sepse më pyeti
17 "Ku është ai tani, ku po punon ai tani?"

18 Më pas, ai donte të më qetësonte. Më tha "Mos u shqetëso.
19 Do bëjmë të njëjtën gjë si Begovic". Dhe kur e tha këtë gjë
20 mua m'u krijua përshtypja që ai nuk kishte ndonjë gjë në dorë.
21 Këtë e thashë duke u mbështetur në zërin që kishte apo në
22 tonin e përdorur ndërsa fliste me mua.

23 PY. Të kthehemi shkurtimisht tek momenti kur keni qenë në
24 pjesën e pasme të veturës Golf, me z. Markovic, dhe ai kishte
25 armë me vete. A ju krijua përshtypja që ai ishte i shqetësuar

1 lidhur me rrethanat e tij apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Çfarë të dha ty këtë përshtypje, pse t'u krijua kjo
4 përshtypje?

5 PË. Mënyra se si ishte ulur. Ai ishte i keqpozicionuar. Ishte
6 i frikësuar.

7 PY. Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva, mund të vazhdoni dhe më
8 tej. Mund të shpjegoni situatën.

9 PË. Më vonë, ndërkohë që po na vozisnin, dhe ku po ktheheshim
10 rrugës ne shkuam në afërsi të vendit ku ata më kishin
11 rrëmbyer, domethënë, nga vendi i rrëmbimit dhe vendi që ishim
12 ne në atë moment ishte rreth, ishim rreth 500 metra. Personi
13 që po na ruante e kishte pushkën drejtuar ndaj nesh. Ai pa
14 shoferin dhe më pas unë iu drejtova, por ai më pa drejt e në
15 sy, ndërkohë që unë i thashë, "Do ishte më mirë që të na
16 vrasësh që tani, në moment". Dhe kjo është diçka që e
17 konfirmova edhe më parë gjithashtu.

18 PY. Ju thatë që e konfirmuat dhe ju gjithashtu. Çfarë po
19 thoni me këtë? Po thoni që edhe ju u thatë atyre që "Më vrisni
20 tani në këtë çast, në këtë moment"?

21 PË. Po. Atë ju thashë, "Do ishte më mirë që të më vrisnit
22 tani, këtu. Këtë thashë.

23 PY. Pse jua thatë këtë gjë, çfarë ju bëri ju që t'ua thonit
24 këtë gjë atyre?

25 PË. Ajo çfarë më shtyu mua ta thoja këtë gjë, është që nuk

1 doja të duroja asnjë torturë të mundshme, dhe familjet tona do
2 të mësonin se çfarë fati kishim. Kështu që arsyeja ishte që të
3 shmangnim torturat e mundshme dhe të siguroheshim që të
4 afërmit tanë do ta merrnin vesh se çfarë na kishte ndodhur ne.
5 Të paktën kjo ishte arsyeja që pse ua thashë këtë gjë unë
6 vetë.

7 PY. Ndonjë nga individët e UÇK-së që ishte në makinë, a ju
8 përgjigj juve? Domethënë, a ju përgjigj juve për atë çfarë ju
9 kërkuat apo çfarë ju thatë, dhe z. Markovic?

10 PË. Jo, nuk pati asnjë lloj reagimi, asnjë lloj përgjigjeje.

11 PY. Z. Ivanisevic, në deklaratat e pranuar --

12 Z. BOYLE: [Përkthim] Për procesverbal është prova
13 materiale P694.3, faqja 21.

14 PY. -- ju aty përshkruani momentin kur u morët nga makina
15 Fiat e juaja dhe pastaj u dërguat tek makina Lada. Do të doja
16 t'i shpjegoni Trupit Gjykses se si fizikisht ishte të,
17 qëndronit juve, ose ishit futur juve tek makina Lada? Tek
18 gepeku i makinës Lada, a mund të na shpjegoni ju lutem?

19 PË. Po, e shpjegoj. Ai ishte pas meje. Kokën e kishte mënjanë
20 dhe këmbët i kishte pas kokës time. Ndërkohë që këmbët e mia
21 ishin ngjitur me kokën e tij, dhe koka ime ishte nga ana
22 tjetër. Dhe përderisa isha i përkulur duhej që të ngrija pak
23 këmbët, kyçet e këmbëve, sepse gepeku nuk mund të mbyllej
24 plotësisht.

25 PY. Çfarë, cila ishte gjëja e parë që z. Markovic, çfarë bëri

1 së pari z. Markovic kur ju u vendosët në gepek, u futët brenda
2 në gepek së bashku?

3 PË. Gjëja e parë ishte që kërkoi që të gjente dorën time, dhe
4 më tha "Mos ki frikë, mos ki frikë". E mbajtëm njëri-tjetrin
5 ashtu me dorën bashkë, dhe e pashë që ishte i frikësuar. Ai më
6 pyeti përnjëherë, "A je polic ti?". Pyetja e parë që më bëri
7 ishte "A ke qenë ti me mua në Golf apo jo?". Unë i thashë,
8 "Po". Dhe pastaj më bëri këtë pyetje tjetër, "A je polic apo
9 jo?". Unë i thashë, "Jo. Po ti?". Dhe e kuptova në fakt që ai
10 më tha "Po", ndërkohë që për pjesën tjetër thjesht kuptova që
11 ai punonte në hekurudhë, asgjë tjetër.

12 Kur unë e pyeta që a je polic, ai tha "Po", por ai shtoi
13 se do thoshte si justifikim për veten që ishte punonjës
14 hekurudhe. Por më vonë, mësova që ai ishte polic dhe punonte
15 si shoqërues, domethënë, shoqëronte këto linjat hekurudhore,
16 punonte në trena.

17 Doni që të vazhdoni më tej, apo mjafton?

18 PY. Jo, mjafton për kaq. Faleminderit.

19 Në deklaratën e pranuar, po ashtu thatë në një pikë që ju
20 jeni mekanik ose keni qenë mekanik. A mund t'i thoni Trupit
21 Gjykues pak më tepër lidhur me faktin që ju thoni që keni qenë
22 mekanik, apo jeni mekanik, dhe çfarë përvoje keni pasur në
23 këtë aspekt në kohën kur ju kanë rrëmbyer?

24 PË. Deri në fund të vitit 1998, unë kam punuar si mekanik
25 makinash, mekanik automjetesh. Dhe në fillim të vitit të ri të

1 1999, për thujajse një muaj e dhjetë ditë a diçka e tillë, unë
2 kam punuar si vozitës, si shofer. Kam shumë përvojë si mekanik
3 automjetesh, kjo është fusha ime e specializimit dhe këtë
4 profesion kam bërë. Dhe kam qenë goxha i mirë në profesionin
5 tim.

6 PY. Mbështetur në këtë përvojë tuajën, si do ta vlerësonit
7 aftësinë tuaj për të identifikuar lloje të ndryshme apo modele
8 të ndryshme makinash, automjetesh, e të tjera?

9 PË. Unë i njoh mirë modelet që janë përdorur në atë kohë,
10 modelet e automjeteve të përdorura në atë kohë. I njoh goxha
11 mirë. Daja im po ashtu kishte të njëjtën lloj makine. Ishte
12 një model nga fillimi i viteve 1970, atëherë ka filluar
13 prodhimi i këtyre automjeteve, nëse nuk gabohem. Domethënë,
14 diku nga fillimi i viteve 1970. Por të paktën, në rastin tonë,
15 mund të bliheshin modele të tilla në fillim të viteve 1970.
16 Dhe rreth vitit 1972 ju mund ta blinit lehtësisht një model të
17 tillë. E njoh shumë mirë një model të tillë. Ishte një model
18 Lada standard. E njihja goxha mirë një model të tillë makine.
19 PY. Po ashtu, në deklaratën e pranuar në provë materiale juve
20 përshkruani automjetin Lada të bardhë, dhe thoni që quhej
21 diçka Zaguli [sipas përkthimit]. A mund të na thoni në qoftë
22 se ka ndonjë emër tjetër një veturë Lada standard ose një
23 Zoguli [sipas përkthimit]. A ka ndonjë emërtim tjetër ose
24 numër tjetër, si mendoni?

25 PË. Po, njihet ndryshe edhe si Fiat 124. Modeli është

1 zhvilluar nga modeli italian i Fiat-it 124. Lada, domethënë,
2 rusët morën leje, licencë, si dhe prodhuan më pas këtë model,
3 veturën.

4 PY. A e dini që ka një emër me të cilin njihet kjo veturë që
5 i referohet madhësisë së motorit të veturës?

6 PË. E di që ka kapacitet 112 metra kub [sipas përkthimit].
7 Megjithatë nuk e kuptoj drejt pyetjen tuaj.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Ka probleme me transkriptin. Ju
9 kërkoj ndjesë, Prokuror.

10 Domethënë sa i takon pyetjes suaj që bëtë lidhur me
11 numrin e veturës, nuk është e reflektuar kjo në transkript.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar i seancës, ka problem
13 në transkript, me çfarë shikojmë përpara, transkripti ka
14 ndaluar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
16 kemi një problem teknik për momentin, do mundohemi ta zgjidhim
17 sa më shpejt të jetë e mundur.

18 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e
19 Gjykatës këshillohen]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendova se e
21 zgjidhëm problemin, por duket sikur nuk e kemi zgjidhur.

22 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e
23 Gjykatës këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sapo më thanë
25 që funksionon siç duhet tani transkripti.

1 Z. BOYLE: [Përkthim]

2 PY. Z. Dëshmitar, përpara sesa të bënim këtë pauzë e shkurtër
3 për të zgjidhur problemin me transkriptin, ju përmendët
4 madhësinë 1200 të motorit. A keni dëgjuar ndonjëherë
5 versionin, për versionin e Lada 1200, keni dëgjuar ndonjëherë
6 këtë?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni, z.
8 Prokuror, znj. Sekretare akoma nuk funksionon transkripti në
9 ekranin tim.

10 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e
11 Gjykatës këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do e provojmë
13 dhe një herë. Mund të vazhdoni, Prokuror.

14 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryesues i
15 Gjykatës.

16 PY. Z. Dëshmitar, po ju pyesja për madhësinë e motorit. Nuk e
17 di domethënë, po jua bëj edhe një herë pyetjen. A e keni
18 dëgjuar ndonjëherë që motorit të këtij automjeti t'i drejtohen
19 si Lada 1200, e keni dëgjuar apo jo?

20 PË. Po, e kam dëgjuar. Quhet 1200 gjithandej, dhe kjo është
21 emërtimi i zakonshëm në gjuhën e përditshme, kështu i
22 drejtoheshin njerëzit kësaj, këtij prodhimi. Dhe arsyeja për
23 këtë është që prej këtij modeli janë zhvilluar më pas modelet
24 e mëvonshme të veturave të tilla.

25 PY. Kur keni pasur mundësi që të flisni me babain e Veljko

1 Markovic, a pati mundësi ai që t'ju thoshte se çfarë lloji
2 veture ka vozitur djali i tij?

3 PË. Po, më ka thënë. Ma konfirmoi që ai voziste atë makinë,
4 atë model, të njëjtën ngjyrë që kisha parë dhe unë.

5 Ekzaktësisht i njëjti model. Pra, edhe si prodhim edhe si
6 ngjyrë, ishte e ngjashme me atë çfarë kisha parë unë. Ai e
7 konfirmoi që i biri i tij voziste një veturë të këtij lloji.

8 PY. Kur thoni një veturë të tillë, e keni fjalën për një
9 veturë Lada të bardhë standarde. Për këtë e keni fjalën?

10 PË. Po.

11 PY. Në deklaratën që tani është pranuar si provë materiale ju
12 thoni që personi me të cilin ishit ndaluar ishte pak më i
13 shkurtër se sa ju. A mund t'i thoni Trupit Gjykses se sa i
14 gjatë jeni, dëshmitar?

15 PË. Një metër e 79 centimetra, kaq i gjatë jam.

16 Z. BOYLE: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të paraqisni
17 në ekran dokumentin SPOE00341655? Është një dokument prej një
18 faqeje. Është një dokument i cili mund të tregohet për
19 publikun. Është një dokument i cili ka versionin serbisht, në
20 shqip dhe në anglisht e gjitha në një faqe.

21 PY. Ky është një shënim për zhdukjen e z. Markovic,
22 dëshmitar, dhe besoj që mund të shikoni, domethënë, ta shikoni
23 dhe vetë që:

24 "Z. Markovic është përshkruar si person i cili ka qenë
25 duke ngarë automjetin e tij të llojit Lada 1200, 17 apo 18

1 vjet të vjetër...”

2 A keni parë ju këtë lloj makine në momentin kur jeni
3 futur te gepeku i z. Markovic?

4 PË. Po, është në përputhje me atë çfarë kam parë.

5 PY. Thuhet gjithashtu në këtë shënim, pra tek pjesa që
6 përshkruan z. Markovic, përshkruhet që ky është një person
7 për afërsisht 175 centimetra i lartë dhe 90 kilogramë. A është
8 kjo në përputhje me atë çfarë keni vënë re ju te personi me të
9 cilit ishit i ndaluar, a përkon kjo me çfarë keni parë ju?

10 PË. Po, përputhet. Ka qenë më pak i, pak më i shkurtër dhe
11 pak më i shëndoshë se unë. Unë isha rreth 75, 79 kile në atë
12 kohë. Pra, pesha ime ishte diku 75, 79. Ai ishte më i mbushur,
13 edhe më i shkurtër, të paktën këtë mund të kuptoja unë.

14 Z. BOYLE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të kërkoja
15 që të pranohet ky dokument.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që nuk
18 ka kundërshtime. Dokumenti i Prokurorisë me numër SPOE00341655
19 pranohet.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 merr numrin e provës materiale P699, dhe gjithashtu dëshiroj
22 t'ju informoj që është klasifikuar si konfidencial, por për
23 shkak se do t'i përcillet publikut, duhet të riklasifikohet
24 tashmë si publik?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta

1 riklasifikojmë si publik?

2 Z. BOYLE: [Përkthim] Po, riklasifikojeni.

3 A mund të vendosim në ekran SPOE00341539. Serbishtja me
4 të njëjtin numër, por thjesht përfundon me ST në fund. Edhe ky
5 është një dokument që mund të transmetohet publikisht.
6 PY. Z. Ivanisevic, ky është një dokument i OSBE-së, siç mund
7 ta shihni dokumenti e ka "Hetimi i policit serb që mendohet,
8 që pretendohet se është rrëmbyer". Është viktima Veljko
9 Markovic dhe Djuric Nebojsa. Dhe thuhet që hetuesit e OSBE-së
10 folën me një punonjës të të drejtave të njeriut të OSBE-së që
11 ju ka intervistuar ju, pra, më 18 shkurt 1999.

12 Dëshmitar, a ju kujtohet të jeni takuar me përfaqësues të
13 OSBE-së disa ditë pas arratisjes suaj?

14 PË. Po, më kujtohet.

15 PY. Në raport jepen disa hollësi lidhur me rrëmbimin tuaj,
16 përfshirë dhe faktin që në një moment ju kanë mbajtur në gepek
17 të automjetit tuaj, një Fiat, dhe më pas tek një Lada. Këto
18 hollësi a janë të sakta dhe a përputhen me atë që na e keni
19 thënë sot?

20 PË. Po, janë të sakta.

21 Z. BOYLE: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument të pranohet.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

23 Z. MISETIC: [Përkthim] S'kemi kundërshtime.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që nuk
25 ka kundërshtime, atëherë dokumenti SPOE00341539 bashkë me

1 serbishten pranohen.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
3 të marrë numrin e provës materiale P700. Edhe e njëjta gjë për
4 klasifikimin.

5 Z. BOYLE: [Përkthim] Mund të jetë, mund të riklasifikohet
6 si publik.

7 PY. Z. Ivanisevic, ju keni thënë në deklaratën që tashmë
8 është paraqitur për t'u pranuar, familja e Nebojsa Djuric
9 erdhi t'ju takonte pasi u arratisët. A mund t'i thoni Trupit
10 Gjykues pse erdhën t'ju takonin?

11 PË. Erdhën që të më pyesnin nëse dija ndonjë gjë për djalin e
12 tyre. Erdhi mamaja, dhe babai i tij, më duket se edhe motra.
13 Ishin tre persona. Babai, mamaja dhe motra, me sa më kujtohet.
14 Nuk jam shumë i sigurt për pjesëtaren e tretë. Erdhën të më
15 takonin për të pyetur çfarë mund t'u thoja, a e kisha parë,
16 por unë nuk e kisha parë.

17 PY. Kur erdhën t'ju takonin, a ju thanë çfarë kishin dëgjuar,
18 apo çfarë kishin mësuar për zhdukjen e Nebojsa?

19 PË. Kishin dëgjuar që kishte ikur me Veljko Markovic dhe nuk
20 ishte marrë, nuk ishte parë më qysh prej atij momenti. Këto
21 kishin dëgjuar sepse dhe ai ishte polic, dhe këtë e kishin
22 mësuar prej kolegut të tij. Dhe s'u pa më kurrë, nuk u kthye
23 më kurrë.

24 Z. BOYLE: [Përkthim] Sekretare, ju lutem të vendosim në
25 ekran dokumentin SPOE00341654 në ekran, është një dokument me

1 një faqe, në të trija gjuhët. Edhe mund të transmetohet
2 publikisht.

3 PY. Z. Ivanisevic, ky është një njoftim për një person të
4 zhdukur, për Nebojsa Djuric. A e shihni ku thuhet:

5 "Zhdukur derisa ishte duke udhëtuar me automjetin e
6 kolegut të tij, Veljko Markovic, Lada të bardhë të vjetër 17
7 ose 18 vjet..."

8 A përputhet kjo me informacionin që keni mësuar ju për
9 zhdukjen e Djuric?

10 PË. Po, përputhet.

11 PY. Po informacioni për automjetin, a përputhet me automjetin
12 që keni parë ju? Dhe në të cilin, në bagazhin e të cilës ju
13 kanë futur edhe ju?

14 PË. Po.

15 PY. Z. Ivanisevic...

16 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Fillimisht do
17 kërkoja që ky dokument të pranohet si provë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
19 SPOE00341654 pranohet bashkë me përkthimet përkatëse.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, materiali merr
21 numrin e provës P701. A duhet riklasifikuar si publik?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe dokumenti
23 riklasifikohet si publik.

24 Z. BOYLE: [Përkthim]

25 PY. Z. Ivanisevic, tani dua të flasim për momentin kur jeni

1 arratisur nga gepeku i automjetit Lada. Ju në deklaratën tuaj
2 keni shpjeguar se kur jeni arratisur, ata që ju kishin mbajtur
3 të ndaluar ju ndoqën dhe filluan t'ju qëllonin me armë, t'ju
4 shtinin me armë. A mund t'i shpjegoni Trupit Gjykues çfarë
5 ndodhi saktësisht kur u arratisët nga automjeti? Sa kohë ju
6 kërkuan këta persona, sa persona ishin, dhe detaje të këtij
7 lloji?

8 PË. Kur hapa gepekun, i pyeta Veljko, çfarë do bëjmë, do ikim
9 me vrap? Pyeta këtë pra, personin që ishte përbri meje. Ai më
10 tha, "Por do na qëllojnë". Unë i thashë, "Më mirë të na
11 qëllojnë, unë do vrapoj". Dhe i thashë se kisha hapur kapakun
12 e gepekut. Ai vendosi krahun ta verifikonte, dhe ai vendosi të
13 largohet, e hapi pak më shumë kapakun dhe më thoshte "Jo
14 s'është ky çasti, s'është ky çasti i duhur. Dhe unë e dija,
15 sepse automjeti ishte shpejt, ishte me 50-60 kilometra në orë.

16 Në një moment, duke qenë se po ngjisnim kodrën, pra deri
17 në ato momente ishte terreni i ulët, i sheshtë, por në
18 momentin që e kuptuam që do ngjisnim kodrën, ishte më e
19 thjeshtë për ne të arratiseshim dhe të fshiheshim në kodër,
20 sepse ai vazhdonte të thoshte, "Do na gjuajnë, do na
21 qëllojnë". Pastaj tha, "Okej, ikim". Ne e ngritëm kapakun, ata
22 e vunë re që u hap kapaku, edhe unë me vrap u largova, e
23 dëgjova që ai vazhdonte të thoshte "Jo tani, jo tani". Por
24 ndërkohë unë kisha dalë nga automjeti, kërceva. Kërceva nga
25 gepeku, rashë, domethënë, rashë në këmbë, dhe fillova të

1 vrapoja larg makinës.

2 Dëgjoja që thoshin "Ndalo". Hapën dyert. Mund të isha
3 rreth 30 metra larg. Qëlluan një herë me armë. Unë rrëshqita
4 dhe rashë, por u ngrita prapë dhe vazhdova të vrapoja për të
5 kapërcyer kodrën. Dëgjoja hapa, dëgjoja, e kuptoja që dikush
6 po më ndiqte, dhe kur më pa sërish, sërish qëllloi me armë, unë
7 prapë rashë, u rrëzova.

8 Por m'u desh të ngjisja kodrën se atje mund të fshihesha,
9 kishte disa shkurre atje. pas 20-30 metrash arrita majën e
10 kodrës. Edhe kur mbërriti ky person atje, qëllloi të paktën tre
11 herë. Ishin të shtëna teke.

12 Pak më vonë, pushova pak, ndalova, po përpiqesha të
13 kuptoja ku ishin. Me sa arrita të kuptoja, nuk kishte asnjë
14 person afër. Kështu që në këto momente unë mendova t'i bija
15 rreth e rrotull vendit. Nuk doja t'i bija përmes, se kisha
16 frikë se mos i hasja, dhe me, në gjykimin tim po kthehesha pak
17 pas, pra po kthehesha në drejtimin nga kisha ardhur.

18 Ndërkohë që po bëja këtë rrugë, në të majtën time, mund
19 të shihja vendin nga isha arratisur, dhe aty dëgjoja të shtëna
20 të ndryshme. Rashë sërish. Unë isha bërë qull se isha, kisha
21 djersitur, kisha vrapuar.

22 Edhe aty kalova një vend ku mendova që mund të fshihesha,
23 kalova një, bëra një kapërcim, kalova në një vend ku mund të
24 fshihesha. Po dilte hëna, kishte borë edhe pamja ishte shumë e
25 qartë në fakt. Pashë një automjet që u kthye dhe kërkonin me

1 elektrikë dore. Kur kalova këtë vendin, pra u fsheha diku në
2 një përrua. Pastaj pashë një shtëpi, madje pashë katër-pesë
3 shtëpi, pashë drita, e dija që do më shihnin kështu që unë u
4 zvarrita, pra me duar e me këmbë. Që ata të mendonin do isha
5 një kafshë dhe jo njeri. Po ecja këmbadoras.

6 U ngjita në kodër, dhe në kodër pashë tre persona, tre
7 hiqe, tre hiqe. Dukej sikur ishin roje. Pastaj u shfaq prapë
8 ky automjeti. Ishte gati 200 metra larg. Dolën nga makina,
9 edhe filluan të vinin në drejtimin tim. Ishin me elektrikë
10 dore që i kishin në makinë. Ishte -- me dritat e makinës po më
11 kërkonin, ishte i njëjti automjet që ishte në Novoselë kur më
12 kapën. Po përdornin pra dritat e makinës.

13 U tremba, se thashë këto tre rojet do më kapnin. Kështu
14 që u tërhoqa pak pas. U ktheva pas. Kishte disa shkurre të
15 ulëta diku. Kishte një gardh ku mbanin gjënë e gjallë, kishte
16 rrethuar gjënë e gjallë, një rrethim. U fsheha mes kafshëve që
17 mos të më dallonin. Gjatë këtij momenti, kur isha futur mes
18 kafshëve, erdhën dhe dy automjete të tjera. Ishin në të
19 njëjtin vend. Të gjithë dolën nga automjeti dhe u shpërndanë
20 për të më kërkuar edhe po vinin në drejtimin tim. Gjatë kohës
21 që unë isha këmbadoras, ata ishin shumë afër. Nuk i shihja,
22 por i ndjeja. Ata përshpërisnin diçka, nuk mund t'ju them
23 saktësisht sa larg ishin, 6-7 metra, por e kuptoja që po ecnin
24 në borë, sepse dëgjoja kërcitja e hapave në borë. Edhe i
25 dëgjoja edhe u ngjitën në kodër, pëshpërisnin.

1 Unë iu afrova pastaj një lumi. Nuk e shihja rrugën se
2 kishte shumë borë, por po shihja dy automjete që vozisnin
3 ngadalë në anën tjetër të përroit. Mendova që personat që
4 ishin mbi kodër më kishin parë. Sidoqoftë ata ishin larguar, u
5 larguan. Kaluan një urë, dhe nuk e pashë më.

6 Pastaj u kthye automjeti i tretë pas, edhe ndezi dritat -
7 - në drejtimin tim. Në ato momente, unë isha brenda në përrua,
8 në shtratin e përroit, isha në shtratin e përroit. Gjatë kohës
9 që ky automjet -- kishte ndezur dritat e makinës në drejtim të
10 rrugës, e pashë që më pas ky automjet u kthye pas dhe u
11 largua.

12 Unë fillova pasja të shkoja në drejtim të pyllit. Pastaj
13 e kuptova në fakt që ato tre hijet që unë mendoja se ishin
14 roje, nuk ishin persona, por ishin thjesht hije të shkurreve.
15 Herë pas here dëgjoja të shtëna me armë zjarri. Nuk isha shumë
16 afër, por i dëgjoja që bërtisnin. Bërtisnin, qëllonin. Dëgjoja
17 automjetet që iknin e vinin përgjatë kësaj rruge të cilën unë
18 e kisha kaluar. Dëgjoja dhe nga ana tjetër e kodrës, kishte
19 disa xhipa që lëviznin. Aq mund të kuptoja unë nga zhurma e
20 motorit.

21 Unë vazhdova të ecja për një kohë shumë të gjatë kur
22 arrita në kodër. Megjithatë, përpara se të mbërrija majën e
23 kodrës, mund të shihja ndriçim, kishte ndriçim në qiell. Dhe
24 sipas meje, dhe mënyra se si u orientova unë, mendova që duhej
25 të ndiqja dritën. Se duhet të ishte drita që tregonte që afër

1 ishte një fshat. Kur u afrova pashë një fshat, mbase ishte
2 fshati Vushtrri. Më vonë në fakt, e kuptova këtë, kur bëra
3 vetë lidhjen e gjërave në mendje.

4 Por pashë drita. Këto ishin mbase dritat në fabrikën e
5 zinkut -- gjatë kohës që po zbrisja kodrën --
6 PY. Okej, më falni që ju ndërpreva. A mund të na thoni në
7 qoftë se si përfundim ju arritët të ishit në një vend të
8 sigurt?

9 PË. Po.

10 PY. Na tregoni shkurtimisht si arritët të shkonit në një vend
11 të sigurt.

12 PË. Kur e kuptova ku isha, ishte zbardhur ndërkohë, kishte
13 dritë. Mund të shihja në fakt fshatin tim, fshatin Vushtrri.
14 Por nuk po e kuptoja dot fillimisht sepse kishte shumë borë.
15 Por kur pashë majtas pashë fabrikën e zinkut, që ishte afër
16 stacionit hekurudhor në Vushtrri, dhe pastaj e pata shumë të
17 qartë në mendjen time.

18 Mund të shihja hekurudhën. Më përpara nuk e kisha parë
19 për shkak të borës që e kishte mbuluar. Por ato momente arrita
20 ta shihja. Por prapë nuk guxoja të ecja në rrugë se kisha
21 frikë se mos mbërrija në ndonjë fshat shqiptar. Kalova shinat,
22 kapërceva shinat dhe ecja, ndiqja drejtimin e shinave për nga
23 fabrika e zinkut.

24 Në këto momente arrita ta shihja.

25 PY. A u hasët në ndonjë moment me ndonjë polic?

1 PË. Po.

2 PY. Kur e takuat këtë polic, ai ku ju çoi?

3 PË. Më çoi në stacionin e policisë në Vushtrri.

4 PY. Faleminderit. E vlerësoj përgjigjet që i dhatë pyetjeve
5 të mia.

6 Z. BOYLE: [Përkthim] Unë nuk kam pyetje të mëtejshme.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
8 keni pyetje?

9 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Mirëmengjes, dëshmitar. Emri im është Luka Misetic. Unë
12 jam përfaqësuesi i z. Thaçi edhe unë kam disa pyetje për ju.

13 Fillimisht kam disa pyetje me historikun, në lidhje me
14 historikun. Ju keni përvojë ushtarake, jeni stërvitur në
15 fushat ushtarake, në fushën ushtarake, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Kur keni, kur e keni kryer shërbimin ushtarak?

18 PË. Në vitin 1982 deri në 1983.

19 PY. Keni kryer shërbim ushtarak në 1998 apo në 1999?

20 PË. Në 1999, u mobilizova. U mobilizova, sigurisht, kur
21 filloi lufta.

22 PY. Përafërsisht, mund të na thoni në cilin muaj ka ndodhur
23 kjo?

24 PË. Që prej 25 marsit, pra muaji i tretë, më 3 mars [sipas
25 përkthimit] -- muajin e tretë të vitit deri në 14 qershor

1 1999.

2 PY. Në cilin njësiti keni shërbyer?

3 PË. Ishte Njësiti i Mbrojtjes Territoriale.

4 PY. Në cilin vend?

5 PË. Në Vushtrri.

6 PY. Pra ju keni shërbyer në Vushtrri nga 25 marsi deri më 14
7 qershor?

8 PË. Kam qenë në këtë zonë. Ndonjëherë shkonim të ndihmonim,
9 të ofronim ndihmë vendet e tjera. Nuk isha gjatë gjithë kohës
10 në Vushtrri, por isha dhe në fshatrat rreth e rrotull.

11 PY. Në rregull, por gjatë kësaj kohe, nga 25 marsi deri në 14
12 qershor ju keni qenë ose në Vushtrri ose në fshatrat përreth
13 Vushtrrisë, kështu?

14 PË. Kam qenë në fshatin tim, kam qenë dhe në disa vende, në
15 vendet që na dërgonin për ndihmë.

16 PY. Për një person që i përcjell lajmet, jam i bindur që ju e
17 dini, i dini krimet që kanë ndodhur në Vushtrri në fillim të
18 majit 1999? Pra, keni dijeni lidhur me këtë? Keni dijeni për
19 vrasjen e rreth njëmijë personave në Vushtrri rreth datës 3
20 maj 1999?

21 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj, çfarë lidhje ka kjo?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Po përpiqem të kuptoj çfarë

24 pjesëmarrje ka pasur dëshmitari në ngjarjet e 3 majit 1999.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ishte kjo një

1 pyetje që u trajtua nga pyetjet e Prokurorit?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po kjo ka lidhje me karakterin e
3 tij.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Fillimisht mund t'i bëni një pyetje të shkurtër në qoftë se ka
6 dijeni në lidhje me këtë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Pyetja -- a keni dijeni për masakrën e rreth një mijë
9 civilëve më 3 maj të 1999, në zonën e Vushtrrisë ku shërbenit
10 dhe ju?

11 PË. Jo, është hera e parë që e dëgjoj këtë gjë. Hera e parë
12 që e dëgjoj për këta një mijë persona.

13 PY. A keni dijeni për vrasje civilësh në zonën e Vushtrrisë?
14 Dhe, më fal, do korrigoj datën, bëhet fjalë për 2 majin e
15 1999.

16 PË. Jo. Kam dëgjuar që janë vrarë civilë, por datën nuk e di,
17 dhe nuk e di se sa persona.

18 PY. E lëmë datën mënjanë. Po themi, nga periudha e 25 marsit
19 deri më 14 qershor 1999, keni pasur dijeni ju që janë vrarë
20 civilë në zonën e Vushtrrisë?

21 PË. Kam dëgjuar që kanë ndodhur vrasje individuale.

22 PY. Nga kush e keni dëgjuar?

23 PË. Nuk mund t'ua them me saktësi. Ka të ngjarë nga personat
24 që njihja. Personat që, me të cilët shoqërohesh.

25 PY. Pra, personat e njësimit tuaj?

1 PË. Jo, jo.

2 PY. Dëshmitar, unë do ju bëj disa pyetje për ngjarjet e 9 dhe
3 10 shkurtit. Pasi u arratisët, domethënë, pasi jeni arratisur,
4 por para se të mbërrini tek stacioni i policisë, ju dëgjuat
5 çfarë i ndodhi z. Markovic, e keni parë në lajme?

6 PË. Jo, s'kam dëgjuar gjë në lajme. Por shumë më pas, shumë
7 kohë më pas, dëgjova që iu gjet mbetjet.

8 PY. Pyetja ime është ndryshe. A keni dëgjuar që z. Markovic
9 dhe z. Djuric ishin rrëmbyer dhe ishin tashmë persona të
10 zhdukur? Ose, më saktë, kur e keni dëgjuar ju për herë të
11 parë, kur e keni marrë për herë të parë lajmin që z. Markovic
12 dhe z. Djuric ishin zhdukur?

13 PË. E kam dëgjuar ditën e dytë ose ditën e tretë, pasi isha
14 kthyer në vendin e punës.

15 PY. Në rregull. Me datë 10 në mëngjes ju shkuat te policia
16 serbe dhe raportuat se çfarë ju kishte ngjarë juve, a është e
17 saktë kjo?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Dhe i dhatë një deklaratë policisë, apo jo?

20 PË. Po.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares që të
22 paraqesë në ekran deklaratën e dhënë, për referencë është
23 dokumenti SITF0004070 [sipas përkthimit] deri në SITF4000493
24 [sipas përkthimit], faqja 9 dhe 10, si në versionin anglisht
25 ashtu dhe në versionin serbisht.

1 PY. Këtë deklaratë tuajën e keni parë më herët, apo jo,
2 dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Kjo është deklarata që i keni dhënë policisë serbe më
5 datë 10 shkurt 1999, kështu?

6 PË. Po.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, Sekretare, kalojeni
8 faqen. Shkoni tek faqja tjetër, si në serbisht ashtu dhe në
9 anglisht. Le të shkojmë në fund të këtij dokumenti.

10 PY. A është nënshkrimi juaj ky, dëshmitar, në fund të
11 dokumentit?

12 PË. Po, është nënshkrimi im.

13 PY. A e keni lexuar deklaratën përpara se sa ta nënshkruani?

14 PË. Kjo nuk më kujtohet. Ndoshta e kam parë.

15 PY. Por është deklarata juaj, apo jo?

16 PË. Po, e vërtetë është. Është deklarata ime. Dhe është
17 pjesërisht e saktë. Jo të gjitha hollësitë janë të sakta.

18 PY. Deklarata është përgatitur pasi policia ju kishte marrë
19 në pyetje tri herë, kështu ka qenë?

20 PË. Deklarata nuk është përgatitur.

21 PY. Po dikush e ka shkruar, apo jo? Dikush e ka shtypur.

22 PË. Ndërkohë që unë po tregoja se çfarë më kishte ndodhur,
23 një nëpunës i policisë po shtypte.

24 PY. Kjo është shtypur, është shkruar pasi juve ju ka marrë
25 tre herë në pyetje policia, a ka qenë kështu, dëshmitar?

1 PË. Unë kam dhënë deklaratën tre herë, edhe ka qenë
2 gjithashtu i pranishëm në kohën kur kam dhënë deklaratën edhe
3 një përfaqësues i OSBE-së. Mbase kjo është shtypur ndërkohë që
4 unë po ju tregoja atyre se çfarë më kishte ndodhur. Ata më
5 kanë marrë në pyetje tri herë. Me sa më kujtohet mua,
6 deklarata po shtypej ndërkohë që unë po tregoja historinë time
7 apo po jepja deklaratën time. Ajo çfarë di unë është që
8 ndërkohë që unë po ju tregoja çfarë më kishte ngjarë, nëpunësi
9 po shtypte.

10 PY. A ju krijua përshtypja që ata ishin veçanërisht të
11 interesuar të marrin detajet prej jush sepse dy prej kolegëve
12 të tyre ishin zhdukur dhe ju treguat, ju thatë atyre, që
13 kishit parë dikë që ju kishte thënë që ishte polic. A ju
14 krijua përshtypja juve që kjo ishte arsyeja që pse ju morën
15 tre herë në pyetje?

16 PË. Jo, jo për këtë shkak

17 PY. A e dini ose a ju thanë ata ju se pse po ju merrnin tri
18 herë në pyetje, për çfarë arsye?

19 PË. Jo, nuk më thanë. Thjesht unë bëra një përmbledhje të
20 situatës tre herë të ndryshme.

21 PY. Juve, ata ju pyetën tre herë të ndryshme, ju morën në
22 pyetje tre herë dhe ju thatë ekzaktësisht të njëjtën gjë, të
23 trija herët, kështu?

24 PË. Po.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do doja që kjo

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04043 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 37

1 deklaratë të shënohet dhe pastaj do ta ofroj për t'u

2 regjistruar si provë materiale.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

4 përsëriteni edhe një herë?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që të shënohet për momentin

6 dhe pastaj do të pranohet si provë materiale.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

8 Z. BOYLE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

10 SITF40004070 deri në SITF40004093 në serbisht dhe në anglisht

11 pranohen si provë materiale.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do

13 të shënohen për momentin për të marrë provën materiale 1D68.

14 Do klasifikohet si konfidencial?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam ndonjë kundërshtim për të

16 qenë publike.

17 Z. BOYLE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

19 vazhdoni, z. Misetic.

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, juve më herët sot paradite, Prokurori ju bëri

22 pyetje se ku janë parë për herë të fundit z. Markovic dhe z.

23 Djuric. Nga e dini ju këtë gjë, pra përgjigja që ju thatë që

24 janë parë në një kafene në Fushë Kosovë, nga e dini këtë

25 informacion?

1 PË. E di sepse kur shkova në punë tre ditë më pas, dëgjova te
2 vendi i punës se kush ishin këta persona. Sepse unë raportova
3 që një person kishte qenë me mua që kishte një makinë të
4 llojit që përshkrova më herët, dhe përderisa këta të dy
5 personat nuk u kthyen në shtëpi, koha kur ishin parë për herë
6 të fundit në kafene përkonte me atë çfarë dija unë. Dhe një
7 person, kamerieri që ishte në atë kafene, tha që ata ishin
8 larguar prej aty në Vushtrri, ose drejt Vushtrrisë ose
9 Mitrovicës.

10 PY. A po thoni këtë, që e keni dëgjuar këtë gjë pra nga
11 persona që po e diskutonin në punë, se nuk e kam të qartë?

12 PË. Kjo është hera e parë kur e kam dëgjuar.

13 PY. A keni vazhduar më tej të kërkonit informacion lidhur me
14 rastin e z. Markovic dhe z. Djuric, përveç atij informacioni
15 që kishit fillimisht? Domethënë, keni kërkuar informacion
16 tjetër shtesë?

17 PË. Nëse po më pyesni, mund të them që babai i tij erdhi dhe
18 më vizitoi katër apo pesë ditë më pas. Ai më pyeti mua për
19 Veljko. Më pyeti për djalin e vet, për Veljko, sepse ai e
20 kishte dëgjuar se çfarë automjeti ishte përfshirë në incident.
21 Më pas, unë dëgjova për fatin e Veljko Markovic, dëgjova se ku
22 ishin gjetur eshtrat e tij, dhe nga ku ishin transportuar në
23 qendrën, në qendrën për mjekësinë forenzike, ku dërgohen të
24 gjitha eshtrat e atyre të cilët gjenden. Domethënë, ishte ky
25 vendi, kishte një vend të caktuar ku dërgoheshin eshtrat e

1 personave që gjendeshin.

2 PY. Pra, ju keni vazhduar që të kërkonit informacion lidhur me
3 rastin e z. Markovic dhe Djuric, që prej rastit të ngjarjeve
4 nga data 9 shkurt e 1999, apo jo?

5 PË. Vetëm një herë kam dëgjuar për fatin e Veljko Markovic,
6 kjo ka ndodhur mbase tre, katër ose madje edhe pesë vite më
7 pas.

8 PY. Prokurori ju bëri disa pyetje lidhur me marrëdhënien
9 ndërmjet Fushë Kosovës dhe vendit ku jeni ndaluar ju. Në
10 Novoselë, a është e saktë?

11 PË. [Nuk ka përkthim]

12 PY. Për të shkuar nga Fushë-Kosova në këtë vendin tjetër
13 duhet të kalosh përmes Prishtinës, apo jo? Dhe pastaj nga
14 Prishtina mund të shkohet, domethënë, në veri-perëndim të
15 Novoselës, Novoselo Madjunsko.

16 PË. [Nuk ka përkthim]

17 PY. Pra, Fushë Kosova është në jugperëndim të Prishtinës dhe
18 Maxhunaj, Novoselo Maxhunaj i takon që është në veriperëndim
19 të Prishtinës, pak a shumë kështu është?

20 PË. Po.

21 PY. Në këtë kohë, cilat forca kishin kontroll mbi Fushë
22 Kosovën?

23 PË. Ishte kontroll që, ishte territori që kontrollohej nga
24 shteti.

25 PY. Po Prishtina, nga kush kontrollohej?

1 PË. Njësoj. Kontrolllohej nga shteti.

2 PY. Po Maxhunaj, nga kush kontrolllohej?

3 PË. Në atë kohë, njerëzit kishin parë pjesëtarë të UÇK-së që
4 kalonin nga kjo zonë, megjithatë, pretendohet që kjo zonë ende
5 të ishte nën kontrollin e shtetit.

6 PY. Po Kleçka? Kleçka i takon që të jetë në jug të Fushë
7 Kosovës, apo jo? Domethënë, të jetë në kah të kundërt nga
8 Maxhunaj, apo jo?

9 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju lutem, duhen pyetje themel -- mbi
10 bazën ku, nga e di, në qoftë se e di dëshmitari se ku gjendet
11 Kleçka.

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. A e dini se ku gjendet Kleçka në Kosovë, dëshmitar?

14 PË. Nuk e di, nuk e di ekzaktësisht. Megjithatë afërsisht në
15 qoftë se ti shkon nga Prishtina në Pejë është në të majtë të
16 rrugës. Megjithatë, ekzaktësisht nuk e di.

17 PY. Por është në kahun e kundërt, domethënë, në qoftë se je
18 në Fushë Kosovë i takon që është nga kahu i kundërt nga
19 Prishtina, kështu?

20 PË. Nuk e di ekzaktësisht se ku gjendet Kleçka, në qoftë se
21 është në drejtim të kundërt apo është pak më shumë në jug.
22 Mund të jetë edhe tërësisht në kah të kundërt, nuk e di. Fushë
23 Kosova është midis Kleçkës dhe Prishtinës.

24 PY. Në rregull. A është e drejtë të thuhet që mënyra se si e
25 kishit kuptuar ju ishte që z. Markovic të paktën ishte marrë

1 nga Fushë Kosova në kontroll të, në territor të kontrolluar
2 nga Serbia dhe ishte vozitur në mënyrë të vazhdueshme nga, në
3 territor që ishte i kontrolluar përsëri nga serbët, dhe siç e
4 thatë juve, pra, ishte territor që ishte i kontrolluar nga
5 qeveria. A është e drejtë të thuhet kjo?

6 PË. Ju lutem, a e përsërisni dhe një herë pyetjen se nuk ju
7 kuptova?

8 PY. Po them, që siç keni dëshmuar përpara Trupit Gjykses, ju
9 keni thënë që z. Markovic është dërguar në, është marrë së
10 pari në Fushë Kosovë dhe nga aty ju e keni parë në Maxhunaj. A
11 e ke thënë këtë gjë apo jo?

12 PË. Nuk e thashë që Markovic e kanë rrëmbyer në Fushë Kosovë.
13 Unë e kam parë atë kur më rrëmbyen mua vetë. E pashë në makinë
14 afër Novoselës. Nuk e kam parë se ku ka qenë ai kur e kanë
15 ndaluar.

16 PY. T'ju bëj një pyetje tjetër. Me sa kam kuptuar nga dëshmia
17 juaj, juve jeni futur në makinë rreth orës 18.30 mbrëmjen e
18 datës 9 shkurt 1999, a është e saktë kjo?

19 PË. Ju lutem, a ma përsërisni edhe një herë, duke më dhënë me
20 një hollësi që ta kuptoj se për çfarë po flisni?

21 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë, por ndoshta do
22 ishte mirë që të na thoni referencën e kohës, sepse janë dhënë
23 disa sqarime në Shënimin përgatitor 1, në paragrafin 13, sa i
24 takon kohës.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që kam lexuar nga deklaratat

1 e 1999, dhënë nga dëshmitari, domethënë, referenca është
2 deklarata që ka dhënë ai në 1999.
3 PY. Në vitin 1999, një ditë pasi kishte ndodhur rasti juaj,
4 ju thoni, që:

5 "Shkova në Obiliq me veturën time private, rreth orës
6 18.00."

7 Është e saktë kjo?

8 PË. Jo.

9 PY. Është deklarata që keni dhënë një ditë pasi rastit që ju
10 ka ndodhur, dhe ju po thoni që informacioni që keni dhënë një
11 ditë pasi ju ka ndodhur ajo çfarë ju ka ndodhur është i
12 pasaktë? Dhe ka qenë ora 18.30, këtë po thoni?

13 PË. Në atë çast nuk është se ishte me interes për mua koha.
14 Nuk është se duhet ta mbaja mend patjetër qartë se sa ishte
15 koha, sa ishte ora kur u largova nga Obiliqi, dhe kur kam
16 shkuar kam thënë nga ora, ka qenë ora 18.00, 18.30, dhe pastaj
17 kam vënë re që në fakt ka qenë 19.00.

18 PY. Në fakt, shënimi është bërë që ora ka qenë 18.30 dhe ju
19 jeni ndaluar në orën 19.00. Domethënë, nuk është e saktë kjo?

20 PË. Jo, jo. Nuk është.

21 PY. Pra, mbështetur në atë çfarë i keni thënë Prokurorit,
22 javën që shkoi, ju e keni spostuar kohën, keni thënë që jeni
23 larguar më herët, domethënë, nuk ka qenë 18.00 apo 18.30, por
24 ka qenë 17.30 dhe ka qenë ora 17.45 ose 18.00 kur jeni hasur
25 me UÇK-në. Pra po thoni që policia e ka regjistruar kohën

1 gabimisht, ka bërë një gabim me rreth një orë diferencë në
2 deklaratën tuaj, dhe pavarësisht këtij gabimi, më datën 10
3 shkurt ju e keni nënshkruar gjithsesi deklaratën, kështu i
4 takon, apo jo?

5 PË. Po, e nënshkrova, edhe atë thashë, atë kam thënë në fakt.
6 Në atë kohë nuk është se kisha mendjen shumë te koha e saktë
7 kur kishte ndodhur. Kam thënë që ka qenë nga ora 18.00 deri në
8 19.00 dhe kështu e kam mbajtur shënim. Por kur jam përpjekur
9 që ta vlerësoj ekzaktesisht se sa ka qenë ora, mendoj se ka
10 qenë aq pra, ka qenë 17.30, jo -- domethënë, ka qenë diku nga
11 ora 18.00, por 17.30 më konkretisht.

12 PY. Për sa kohë qëndrove ti në kafenenë në Malishevë.

13 PË. Nuk është Malishevë, por Miloshevë. Miloshevë, është vend
14 tjetër. Është një vend i cili është ndërmjet Prishtinës dhe
15 Vushtrrisë.

16 PY. Të kërkoj ndjesë, në Miloshevë, jo në Malishevë. Në
17 Miloshevë, sa kohë shpenzove ti në kafene?

18 PË. Ndoshta një orë, një orë e gjysmë maksimumi.

19 PY. Gjatë kësaj ore apo një orë e gjysmë, ju pitë tre apo
20 katër pije, apo jo? Gota, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Çfarë pive?

23 PË. Neve e quajmë raki atë.

24 PY. Pra, pive tre apo katër gota raki për një orë, një orë e
25 gjysmë, dhe pastaj more makinën, dhe u nise për rrugë, kështu?

- 1 PË. Po.
- 2 PY. Nga përvoja jote, na tregoni çfarë ndikim kanë tre apo
3 katër gota raki të pira në një orë apo në një orë e gjysmë,
4 mbi ju?
- 5 PË. Nuk më bën ndonjë gjë, e përballoj mirë.
- 6 PY. A ka ndikim mbi arsyetimin tuaj?
- 7 PË. Jo shumë, ndoshta pak. Jo shumë.
- 8 PY. Po shikimin, ta prek rakia?
- 9 PË. Jo, jo.
- 10 PY. Do t'ju bëj disa pyetje lidhur me personin që ju ndaloi.
11 A pajtoheni me mua që policia kur ju mori në pyetje tri herë,
12 a ishin shumë të interesuar që të dinin sa më shumë hollësi të
13 ishte e mundur lidhur me njerëzit që ju kishin ndaluar, është
14 e saktë kjo?
- 15 PË. Ata nuk më pyetën fare për personat që më kishin ndaluar.
16 Më pyetën vetëm lidhur me rastin.
- 17 PY. Nuk ju pyetën ju fare ata se çfarë kishin veshur
18 personat?
- 19 PË. Këtë pyetje ma bënë, pavarësisht se unë jua thashë vetë,
20 por më pyetën.
- 21 PY. Ata donin, ishin shumë të interesuar që ju të jepnit një
22 përshkrim të personave që ju kishin ndaluar, kështu?
- 23 PË. Donin të dinin se kush ishte personi që më ndaloi, por
24 nuk është se më kërkuan ndonjë përshkrim të hollësishëm për
25 fytyrat e tyre, apo për uniformat, apo jo.

1 PY. Po ti nuk njohe askënd nga ata, apo jo?

2 PË. Jo.

3 PY. Ju nuk mundët të identifikonit ndonjë, domethënë, nuk
4 njohët njeri as me emër as me mbiemër, as me nofkë, kështu?

5 PË. Jo, nuk identifikova dot askënd.

6 PY. Ju nuk i thatë policisë që ata kishin veshur uniforma me
7 emblemat e UÇK-së, kështu?

8 PË. E kam thënë këtë, sepse e kam parë stemën e UÇK-së.

9 PY. Po deklarata që i keni dhënë policisë në deklaratë nuk
10 thuhet që personat që kishin veshur uniforma me lara kishin
11 emblemen e UÇK-së në uniformë. Pse nuk është kjo si gjë, ky
12 detaj, pse nuk është në deklaratën tuaj të 1999?

13 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj, mund të jetë spekuluese
14 sa i takon individëve që e kanë marrë deklaratën.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

16 Z. MISETIC: [Përkthim]

17 PY. Kjo është deklarata juaj, dëshmitar, apo jo? E keni
18 nënshkruar këtë deklaratë.

19 PË. Po, e kam nënshkruar.

20 PY. Keni nënshkruar një deklaratë që nuk përmend asnjë simbol
21 ose embleme identifikuese të UÇK-së, kështu?

22 PË. Nuk e kam vlerësuar si të rëndësishme këtë deklaratë në
23 atë kohë.

24 PY. Është dëshmia -- dëshmia juaj është që i keni thënë
25 policisë që ka pasë embleme UÇK-je, por fakti është që nëse

1 kjo si hollësi nuk përmbahet, ose nuk përfshihet në deklaratën
2 tuaj, i takon që ju nuk ia keni thënë policisë, apo jo? Apo e
3 kundërta, që ju ua keni thënë dhe ata nuk e kanë vënë si
4 shënim?

5 PË. Unë thashë që ata kishin emblemën identifikuese. Në qoftë
6 se e ka përfshirë policia apo jo në deklaratën që kam dhënë
7 unë, këtë nuk e di, nuk mund t'jua them.

8 PY. I keni thënë EULEX-it në deklaratën tuaj që uniformat e
9 ushtrisë ishin si me ngjyrë gri, si të hirtë, në ngjyrë, a
10 është e saktë kjo?

11 PË. Drejtuesi i grupit që ishte ulur ngjitur me mua, kishte
12 veshur uniformën e ushtrisë tonë. Ai kishte këtë uniformë të
13 veshur, dhe të tjerët kishin uniforma të tjera. Dhe një tjetër
14 kishte një uniformë me ngjyrë të hirtë, ai që ishte në
15 Çiçavicë, në Reshnik. Ndërkohë që dy të tjerë kishin xhaketa
16 prej lëkure.

17 PY. Kur thoni "ushtria jonë", "të ushtrisë tonë" e keni
18 fjalën për ushtrinë jugosllave apo jo?

19 PË. Po. Po, ai kishte veshur një xhaketë të ushtrisë
20 popullore të Jugosllavisë.

21 PY. Pra, po thoni që ky personi i UÇK-së kishte veshur një
22 xhaketë të ushtrisë jugosllave? Domethënë, po thoni që kishte
23 veshë xhaketë të ushtrisë jugosllave, por ishte i UÇK-së, këtë
24 po thoni?

25 PË. Po. Po, sepse kishte këtë shenjën UÇK.

Dëshmitari: W04043 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 47

1 PY. Në rregull, po në çfarë vendi e kishte këtë stemën e UÇK-
2 së në xhaketën e ushtrisë jugosllave, dhe nga e dije ti që
3 ishte xhaketë e ushtrisë jugosllave?

4 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju lutem mund ta shkruani për
5 procesverbal shenjën që sapo bëri dëshmitari?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
7 procesverbal, dëshmitari preku krahun e tij të majtë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Pra, ku ishte? Edhe një herë?

10 PË. Në krahun e majtë.

11 PY. Tani po më ngatërron pak se thatë që kishte edhe shenjën
12 e ushtrisë jugosllave, por kishte gjithashtu edhe shenjën e
13 UÇK-së, këtë po thoni?

14 PË. Jo, xhaketa nuk ka pasë asnjëherë shenjë dalluese të
15 ushtrisë jugosllave. Unë e di shumë mirë këtë gjë se kam
16 veshur dhe vetë uniforma të tilla dhe e di që nuk ka pasur
17 asnjë sinjal dallues të ushtrisë jugosllave.

18 PY. Herën e parë që ju keni përmendur për sinjale, apo për
19 këto shenjat, emblemat e UÇK-së, këtë e keni thënë për herë të
20 parë në vitin 2022, për ZPS-në, apo jo?

21 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj, sepse kjo është diçka
22 që i është thënë edhe policisë në vitin 1999.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Po bëj pyetjet e mia.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

25 Jepini përgjigje pyetjes.

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Kur jeni intervistuar nga policia serbe, nuk i keni
3 përmendur fare këto emblemat dalluese të UÇK-së. A është e
4 saktë kjo, dëshmitar, apo jo?

5 PË. E kam përmendur, e kam përmendur emblemat e UÇK-së.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
7 procesverbal, ai më herët tha që ju ka thënë, por nuk e di në
8 qoftë se kjo është reflektuar apo jo.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe unë e kundërshtoj këtë, nuk e
10 pranoj atë çfarë thamë.

11 PY. Dëshmitar, ju nuk e keni përmendur, nuk keni përmendur
12 asgjë lidhur me emblemat e UÇK-së, as një deklaratën tuaj që i
13 keni dhënë EULEX-it, apo jo?

14 PË. Jo, e kam përmendur për EULEX-in. Ju kam thënë që e kam
15 parë emblemen e UÇK-së. Ia kam thënë edhe OSBE-së, kam shkuar
16 në zyrat e OSBE-së në Prishtinë me babanë e Veljko dhe
17 gjithmonë kam thënë që ata kishin emblema të UÇK-së. Në çdo
18 rast kur kam folur e kam thënë këtë gjë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoja që të paraqitet në
20 ekran dokumenti SITF00010993 deri në 00011013 RED, faqja
21 konkrete është SITF00010994. Vazhdojmë tek ky paragrafi kur
22 fillon me "Kur mbërrita në fshatin Maxhunaj..."

23 PY. Atëherë EULEX-i thotë që:

24 "Kur mbërrita afër Maxhunajt, pashë dy automjete të
25 parkuara në anë të rrugës. Ishte një automjet i tipit Golf II

1 dhe një tjetër Opel Escona.

2 "Teksa u afrova dy burra dolën nga Golf-i edhe më
3 drejtuan një dritë. I pashë që ishin të armatosur dhe kishin
4 veshur një lloj uniforme ushtarake të përzier. Kështu si
5 ngjyrë të hirtë, në ngjyrën -- në qoftë se nuk gabohe.

6 Në deklaratën që i keni dhënë EULEX-it nuk përmendet
7 asgjë lidhur me çfarë mund të keni thënë ju lidhur me stemë të
8 UÇK-së. Çfarë po thoni? Thoni që edhe në këtë rast hetuesit e
9 EULEX-it e kanë lënë pa reflektuar në procesverbal, domethënë,
10 ju e keni thënë, por ata nuk e kanë shkruar? Këtë po thoni dhe
11 kësaj radhe?

12 PË. Jam i sigurt që e kam përmendur këtë. Hetuesi i EULEX-it
13 erdhi dhe bisedoi me mua në shtëpinë time. Ai mbajti shënim
14 çdo gjë që thashë. Jam i sigurt që e kam thënë këtë detaj.
15 Sepse më kujtohet që në atë çast, kur ai më pyeti për
16 uniformën, unë përmenda uniformat me lara, por u përmenda
17 gjithashtu edhe këto uniformat si ngjyrë ulliri të përhirtë.

18 Thashë që janë dy uniforma të ndryshme, pra kishin veshur
19 dy lloje të ndryshme uniformash. Njëri prej tyre kishte veshur
20 një uniformë me ngjyrë të hirtë, ai që më drejtoi armën në
21 ballë. Dhe ai kishte këtë uniformën me ngjyrë të hirtë,
22 sikurse e thashë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi mbërritur në kohën e
24 pushimit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi gjysmë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04043 (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 50

1 ore pushim, dëshmitar. Kështu që do t'ju shoqërojë Sekretarja
2 nga salla e gjyqit. Ju kujtoj që nuk mund të flisni me askënd
3 për dëshminë e dhënë para Trupit Gjykues. Dëshmitar, e kam me
4 ju, më dëgjoni, ju lutem. Nuk mund të flisni me askënd lidhur
5 me dëshminë e dhënë para Trupit Gjykues, jashtë kësaj salle
6 gjyqi. A e kuptoni këtë?

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, po. Në rregull.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të dilni
9 tani nga Gjykata.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
12 pushim deri në orën 11.30.

13 --- Pauza fillon në orën 11.03

14 --- Seanca rifillon në orën 11.31

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
16 Sekretare e Gjykatës, të kalojmë në seancë private.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente,
2 sillni dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Dëshmitar, jemi gati të vazhdojmë me kundërpjetjet. Z. Misetic
6 ka disa pyetje të tjera për ju.

7 Vazhdoni, z. Misetic.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

9 PY. Dëshmitar, dua të bëj një korigjim në fakt për
10 procesverbal. Edhe dua që të vazhdojmë pak më shumë me
11 diskutimin sa u takon emblemave të UÇK-së që ju i keni parë,
12 por ju keni dhënë deklaratë. Dhe këtë po e them për
13 procesverbal, ju keni thënë keni dhënë deklaratë ën 2001 në
14 fakt ku r keni përmendur emblemën e UÇK-së.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për palët është dokumenti
16 U000-8450 - U000-845

17 PY. Tani kam disa pyetje. Nga përvoja juaj personale, a ishte
18 e zakonshme të shihej njerëz me emblema të UÇK-së në
19 territoret që i kontrollonte qeveria?

20 PË. Nuk ishte e zakonshme. Unë deri në ato momente nuk kisha
21 parë, pra, deri në momentin që më rrëmbyen, vetëm në
22 televizion e kisha parë. Nuk ishte e zakonshme ta shikoje në
23 përditshmëri.

24 PY. Kur ju ndalën, kur ju ndali ky grup, çfarë ishte, ishte
25 punkt? Çfarë ishte? Ishin në krahë të rrugës dhe ju dhanë

1 urdhër të ndaleshin?

2 PË. Jo, nuk ishte punkt. Ishte në hyrje të fshatit Novoselë.

3 A mund t'jua përshkruaj?

4 Para se të mbërrija në këtë pikë, ishte errësirë, pashë
5 disa automjete në hyrje teksa i afroheshe fshatit, një nga
6 automjetet lëvizti. Nuk jua them dot saktë a ishin dy apo ishin
7 tre automjete. Po dy ishin me siguri, po mund të ketë qenë dhe
8 një e tretë. Nejse nuk ka rëndësi. Unë i kalova dhe më
9 kujtohet që unë kisha lënë të takoja shokët në një kafene.

10 E ktheva makinën pas dhe po e vozisja në drejtim të
11 Prishtinës, pastaj ndryshova mendje. Ndryshova mendje,
12 ndërkohë ata ishin larguar. Dhe kur e ktheva sërish makinën
13 pas, pashë që një nga automjetet lëvizti pak dhe ishin në krah
14 të rrugës. Pashë një burrë, një person, pjesëtar i UÇK-së që
15 kërceu nga sedilja e pasme e automjetit me një automatik,
16 pushkë automatike. Pastaj pashë një tjetër që ishte në të
17 djathtë dhe një person i tretë ishte afër Opel Ascona dhe më
18 drejtoi pistoletën.

19 Personi që kërceu nga sedilja e pasme, më pyeti diçka, po
20 unë nuk kuptoj shumë mirë shqip. Më pyeti diçka në shqip, po
21 unë s'e kuptova. Dhe mendova, okei, nuk është ndonjë gjë.
22 Pastaj me vete mendova tani kam vetëm një shans. Pastaj më
23 foli në serbisht, më pyeti si e ke emrin. Ia thashë emrin. Më
24 pas më tha "Dil".

25 Kur dola nga automjeti, ai përdori pushkën automatike për

1 të më bërë një kontroll, për të më kontrolluar pra. Dhe më
2 tha, "Po vozisje shumë shpejt".

3 PY. Në deklaratën e 2001 ju keni thënë:

4 "Unë mendova që ka qenë një pikë policie..."

5 Pse menduat ju që kjo ishte një pikë e policisë, pikë
6 ndalimi policie?

7 PË. E thashë kur dhashë deklaratën sepse më pyetën tri herë.

8 Nëse kam thënë që më kontrolluan, e kam thënë gjatë

9 intervistave në stacionin e policisë. Sepse më kanë

10 intervistuar tre herë. Një herë filluan nga mesi i historisë.

11 Mbase po përpigeshin të verifikonin apo thoja të vërtetën. Nuk
12 e di.

13 PY. Në rregull. Dëshmitar, vazhdojmë flasim për momentin që

14 keni hasur personin, që besoni tashmë që është z. Markovic. Së

15 pari, ka qenë errësirë, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Kur e hasët për herë të parë këtë person, ishte i ulur në

18 një automjet që po ecte, që vazhdonte përpara, domethënë,

19 ishte përpara, ishte i përkulur përpara?

20 PË. Ishte në sediljen e pasme të automjetit përkulur, i

21 përkulur përpara, pra, ishte i përkulur me trup.

22 PY. Pra, ju fytyrën nuk mundët t'ia shihnit qartë në atë

23 moment?

24 PË. Jo, nuk mundja ta shihja fytyrën e tij.

25 PY. Dhe nuk mundët as të bisedonit kur u ulët në sediljen e

1 pasme të Golf?

2 PË. Jo, në atë moment jo.

3 PY. Kur ju intervistoi policia ditën e nesërme, ata deshën të
4 dinin, pra, ishin të interesuar në një përshkrim të personit
5 që kishte qenë me ju në Golf, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Ju nuk ishit në gjendje t'u përshkruanit teshat që kishte
8 ky person, kështu?

9 PË. U dhashë përshkrim. Kishte një xhaketë të errët me një
10 vizë të bardhë në krah.

11 PY. Xhaketa dhe kjo pjesa e bardhë nuk është e reflektuar në
12 deklaratën e 1999 ndonëse ju e keni nënshkruar. A keni ndonjë
13 shpjegim pse nuk është kjo hollësi në këtë deklaratë?

14 PË. Ishin thjesht të interesuar në ngjarje. Atyre u
15 interesonte vetëm ngjarja. Unë u tregova versionin tim të
16 historisë. Ata nuk është se po dëgjonin, thjesht po shtyptin
17 në një makinë shkrimi. Unë u përshkrova çdo gjë. Mbase nuk
18 kanë pasë mundësi të më ndjekin. Dhe deklarata që kam dhënë
19 për OSBE-në, në Prishtinë mund të jetë shkruar kjo gjë atje.

20 PY. Ata ju kanë pyetur tre herë dhe ju thatë që u interesonte
21 përshkrimi, por ama përshkrimi nuk është në deklaratën e 1999.
22 Po thoni tani që e ka heq, e ka fshirë policia, s'e ka futur
23 policia këtë gjë?

24 PË. Është e mundshme. Është e mundshme të jetë lënë jashtë.

25 Kur thashë që nuk kam parë qartë, kam parë vetëm xhaketën, nuk

1 është se më pyetën më gjatë. Unë thjesht u thashë që ishte më
2 i shkurtër, që ishte trup i mbushur, kishte një xhaketë të
3 zezë me një vizë të bardhë në krah të xhaketës, s'më pyetën,
4 nuk më kërkuan përshkrim tjetër.

5 PY. Në rregull. Të flasim tani për momentin kur e keni hasur
6 këtë person në gepekun e Lada.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim deklaratën që i ke dhënë
8 EULEX-it SPOE0078072 deri në SPOE0007802709 [sipas
9 përkthimit], në faqen 00078076. Shkojmë tek pjesa ku thuhet:
10 "më pas më dhanë urdhër të futesha në gepek".

11 Është paragrafi i dytë.

12 PY. Dëshmitar, unë do jua lexoj, ju ua kanë lexuar këtë
13 deklaratë dhe ju e keni nënshkruar. Thuhet:

14 "Më pas më urdhëruan të futesha në gepek të Lada. Ishte
15 një person brenda ndërkohë, kështu që vendi ishte shumë i
16 vogël. E dallova që ky ishte i burgosur që ishte i ulur përbri
17 meje në Golf.

18 Më zgjati dorën, ishte shumë i trembur. Më pyeti 'A je
19 oficer policie?' Unë i thashë se nuk isha dhe e pyeta 'Po ti?'
20 dhe ai u përgjigj 'Po, unë punoj te stacioni hekurudhor'

21 PY. Këtë ua kanë lexuar ju mbrapsht në serbisht, a ju
22 kujtohet dhe ju të keni pasur këtë bisedë me këtë persona që
23 ishte në gepek të automjetit?

24 PË. Po.

25 PY. Më herët keni thënë se ishte shumë errësirë në gepek dhe

1 ishte shumë e vështirë të shihje, të dalloje, të shquaje gjë,
2 kështu?

3 PË. Unë e pashë në momentin që po hyja në gepek në këto
4 momente e pashë. Më pas nuk arrita ta shihja më. Ishte
5 thjeshtë kjo bisedë mes nesh.

6 PY. Patë ndonjë shenjë keqtrajtimi në trupin e tij, nuk
7 mundët pra, se ishte errësirë?

8 PË. Jo, nuk pashë asnjë shenjë. Asgjë të këtij lloji

9 PY. Ju nuk mund të shihnit se kishte dhe drita makinash të
10 ndezura që reflektonin, kështu që nuk arrinit të shquanit
11 qartë, kështu?

12 PË. Po, kishte shumë arsye. Kishte drita makinash, kishte
13 hije. Po ashtu po përpiqesha të kuptoja çfarë të bëj, nuk e
14 pashë shumë, nuk e kisha parë shumë mirë më përpara.

15 PY. Sa i takon kësaj bisede të shkurtër që patët me të, ju i
16 keni thënë Prokurorit që biseda ishte kështu. Unë do jua
17 lexoj.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Është në provën materiale P694
19 Pjesa 3, faqja 23.

20 PY. "Unë e pyeta: A jeni oficer policie? Ai mu përgjigj
21 diçka, po, po ishte shumë zhurmë për shkak se po xhironin
22 gomat e makinës dhe automjeti po merrte shpejtësi dhe unë nuk
23 ia dëgjova shumë qartë përgjigjen po dëgjova që përmendi
24 hekurudhën".

25 Kjo është biseda që ju kujtohet dhe ju?

Dëshmitari: W04043 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 58

1 PË. Unë e dëgjova që ai tha jam polic. Pjesën e dytë, mua mu
2 duk sikur tha punoj për hekurudhën apo për shoqërinë
3 hekurudhore. Por ama e dëgjova që e tha që jam polic. Dhe me
4 sa kuptova, ai po përpiqej të justifikohet dhe tha po unë
5 punoj për hekurudhën.

6 PY. E kuptoj. Po unë dua të bëjmë dallimin mes asaj që
7 mendoni ju se keni dëgjuar dhe atë që ju ka thënë konkretisht.
8 Pra, ajo që ju i keni thënë ZPS-së dhe që unë jua lexova,
9 është kjo, "Po" dhe diçka që përmend fjalën hekurudhë?

10 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj. Është bërë pyetja është
11 marrë përgjigja.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

13 Përgjigjuni, Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: Unë kam dhënë sqarime të mëtejshme. Unë e
15 dëgjova qartë kur tha "Po", "Po, jam". Sa i përket fjalëve të
16 tjera, për shkak të situatës, nuk e di tha "Do them" o se "Do
17 justifikohem", këtë nuk e kuptova. E vetmja gjë që unë kam
18 dëgjuar ishte fjalë "Hekurudhë" ose "Shoqëria hekurudhore" ose
19 "Punoj në hekurudhë". Por këtë e dëgjova qartë, e vetmja gjë,
20 togfjalësh që dëgjova ishte që ishte punëtor hekurudhe.

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Ju treguan disa foto të Veljko Markovic kur ju vizitoi
23 babai i tij, kështu?

24 PË. Më treguan fotografinë e tij te OSBE-ja nga Lynn Holland,
25 ishte punonjës i OSBE-së, se ua kishte çuar i ati fotografinë

1 përpara se të vinte të më takonte mua dhe para se të shkonim
2 së bashku atje.

3 PY. Ju nuk ishit në gjendje ta identifikonit apo ta dallonit
4 Veljko Markovic në asnjë prej këtyre fotografive, kështu?

5 PË. Jo, fytyrën jo. Vetëm trupin, staturën. Fotografia që më
6 tregoi Lynn Holland, ishte, pra, në këtë fotografi ai kishte
7 veshur të njëjtën xhaketë me atë vizën e bardhë. Kjo më
8 kujtohet shumë mirë. Ishte ulur në një divan, kishte të
9 njëjtën xhaketë, por ama, fytyrën nuk ia dallova dot.

10 PY. Kjo është xhaketa që e keni përfshirë në deklaratën e
11 mëpasshme po jo në deklaratën që i keni dhënë policisë në
12 1999, kështu?

13 PË. Është e mundshme. E di që e kam përmendur. Nuk e di
14 arsyen pse nuk është shënuar. Por ka shumë hollësi që
15 mungojnë. Veçanërisht në deklaratën e EULEX-it, hollësitë dhe
16 kronologjia e ngjarjeve nuk është fare e saktë.

17 PY. Së fundi, Dëshmitar, juve ju treguan dy prova materiale
18 P699 dhe P701, të cilat ishin lajmërimet për zhdukjen e Veljko
19 Markovic dhe Nebojsa Djuricic dhe aty thuhet se për herë të
20 fundit ishin parë së bashku në automjetin Lada 1200.

21 A është e vërtetë që ju e keni parë, ju keni parë një
22 person që besoni se është z. Markovic por nuk e keni parë një
23 person të dytë?

24 PY. Po. Personi tjetër Nebojsa Djuric, s'e kam parë
25 asnjëherë.

1 PY. Ju bënë disa pyetje për përvojën tuaj si mekanik për
2 automjetet Lada. A ishte shumë e përhapur Lada standarde në
3 Kosovë në vitin 1999?

4 PË. Jo, nuk ishte shumë e zakonshme në atë kohë. Kishte
5 modele të tjera të Lada, po në ato momente nuk ishte shumë e
6 përhapur, ishte model i vjetër dhe nuk përdorej më në atë
7 kohë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 z. Misetiç.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

14 Z. Baiesu.

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
16 këshillohen]

17 Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu:

18 Z. BAIESU: [Përkthim]

19 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
21 filloni duhet të bëjmë një pushim dhjetë minuta. Duhet të
22 bëjmë një pushim prej dhjetë minutash.

23 Shoqërojeni dëshmitarin jashtë sallë.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë

1 minuta pushim.

2 --- Seanca ndërpritet në orën 11.57

3 --- Seanca rifillon në orën 12.04

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

5 Sekretare, mund ta sillni përsëri dëshmitarin në sallë.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

8 Dëshmitar. Do të vazhdojmë me pyetjet e z. Baiesu.

9 Z. Baiesu, fjala për ju.

10 Z. BAIESU: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

11 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë quhem Victor Baeisu. Jam

12 përfaqësuesi i Jakup Krasniqit dhe kam disa pyetje ose më

13 shumë sesa pyetje kam disa sqarime për të bërë lidhur me

14 deklaratën e dhënë më herët sot.

15 Sot më herët, kur po përshkruanit mënyrën sesi ikët, ju

16 thatë:

17 "... i thashë Veljko, 'Çfarë do bëjmë?'"

18 Z. BAIESU: [Përkthim] Për referencë kjo është faqja 24,

19 rreshtat 22 dhe 23 të transkriptit të përkohshëm të ditës së

20 sotme.

21 PY. Për ta sqaruar, Dëshmitar, ju ia bëtë këtë pyetje

22 personit që ishte ngjitur me ju në gepek. Ju nuk mund të

23 konfirmoni se kush ishte personi ose personi që ishte ngjitur

24 me ju në gepek ishte Veljko Markovic, kështu?

25 PË. Po, ia drejtova pyetjen personit që ishte ulur ngjitur me

1 mua në gepek, por unë e dija se kush ishte personi që ishte
2 ulur ngjitur me mua në sediljen e pasme të Golf.

3 PY. Kam një tjetër sqarim.

4 Z. BAIESU: [Përkthim] Për procesverbal, kjo është faqja
5 38, rreshtat 8 deri në 10 të transkriptit të përkohshëm sot.

6 PY. Do jua lexoj. Ju thatë:

7 "Unë nuk e thasë që Markovic u rrëmbye në Fushë-Kosovë.
8 Unë atë vetëm e kam parë kur më rrëmbyen mua e pashë pranë
9 makinës në Novoselë".

10 Përsëri, Dëshmitar, po ju pyes ju nuk konfirmoni dot se
11 personi që patë ishte Veljko Markovic, a është kështu apo jo?

12 PË. Nuk mund të thoja atëherë me siguri që ishte Veljko
13 Markovic. Thjesht e përshkrova mbështetur në përshkrimet apo
14 karakteristikat e tij dhe pastaj çfarë ndodhi më vonë kur
15 erdhi i ati për të më takuar, mbërrita në përfundimin që bëhej
16 fjalë për Veljko Markovic, që personi ishte Veljko Markovic.

17 PY. Dëshmitar, ti nuk e identifikon dot, nuk e identifikove
18 me siguri dëshmitarin që ishte ngjitur me ju në automjet,
19 kështu?

20 PË. A mund ta bëni pak më qartë pyetjen, ju lutem? Unë nuk e
21 identifikova dot me hollësi, me detale, por munda që t'i jepja
22 një përshkrim të siluetës së tij, domethënë, çfarë trupi
23 kishte apo çfarë xhakete kishte.

24 PY. Në momentin kur ju ishit bashkë në gepek ju nuk e dinit,
25 nuk e dije me siguri se kush ishte personi, apo jo?

1 PË. Jo, nuk ia dija emrin dhe mbiemrin. Këto hollësi nuk i
2 dija. Nuk e dija si e kishte emrin dhe mbiemrin.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju
4 dëgjova, Prokuror. Çfarë thatë?

5 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. U bë pyetja dhe u
6 përgjigj. Kjo pyetje është bërë dhe është përgjigjur.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
8 kundërshtimi.

9 Është bërë kjo pyetje disa herë në qoftë se doni të bëni
10 pyetje të tjera sqaruese mund të vazhdoni me pyetje sqaruese.

11 Z. BAIESU: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
12 Nuk kam më pyetje tjera.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
14 çaktivizuar]

15 Z. BOYLE: [Përkthim] Sekretare e seancës, a mund të
16 paraqisni në ekran dokumentin SPOE00208166. A mund ta zmadhoni
17 te kuadrati D3. Sepse ka shifra dhe numra domethënë shifrat
18 janë në fillim fare dhe pastaj numrat janë të vektorit tjetër.
19 Mund ta zmadhoni pak më tepër. Shumë faleminderit. A është e
20 mundur që t'i japim diçka për të bërë shënime Dëshmitarit, një
21 stilolaps ose një laps.

22 Pyetje vijuese nga z. Boyle:

23 Z. BOYLE: [Përkthim]

24 PY. Z. Dëshmitar, do ju kërkoj që të shënoni disa prej
25 vendeve që keni diskutuar gjatë dëshmisë tuaj. Ju kërkoj

1 ndjesë, se emrat në këtë hartë nuk janë në serbisht janë në
2 shqip, ju kërkoj ndjesë për këtë. Megjithatë shpresojmë që të
3 mund të vazhdojmë më tej me përshkrimin.

4 Së pari, ju lutem a shënoni dot vendin nga ku u nisët,
5 natën 9 shkurtit, Miloshevën a e shënoni dot aty në hartë. She
6 pastaj do t'ju jap udhëzime të tjera në qoftë se keni nevojë
7 për ndihmën time.

8 PY. Besoj që do gjej rrugën. Megjithatë më lejoni vetëm një
9 çast.

10 Z. BOYLE: [Përkthim] Znj. Sekretare, është e mundur ta
11 zmadhoni pak më shumë hartën? Faleminderit.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Po e shikoj Miloshevën, e shikoj
13 këtu në ekran. Vetëm një çast, ju lutem, se lexoj këtu në
14 hartë që lexon Miloshevë, megjithatë më jepni një minutë sa ta
15 shoh pak. Është Obiliqi. Duhet të jetë diku këtu. Këtu
16 Miloshevë.

17 Z. BOYLE: [Përkthim]

18 PY. Shumë faleminderit, Dëshmitar.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Prokuror, a mund t'i
20 kërkonit që të vendosë një numër në këtë vend?

21 Z. BOYLE: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, a mund të vendosni numrin 1 ngjitur me këtë
23 vendin që keni identifikuar?

24 PË. [Shënon]

25 PY. Faleminderit. A mund të gjeni se ku është Novosela ku

1 jeni ndaluar këtu në hartë?

2 PË. Po.

3 PY. A mund të vendosni numrin 2 këtu?

4 PË. [Shënon]

5 PY. Në dëshminë tuaj thatë gjithashtu që ishte një vend që
6 quhej Pestovë ku ju thatë që filluat që të vozisnit me kerrin
7 tuaj, me makinën tuaj, me Fiat. A mund ta rrethoni dhe këtë
8 vend këtu në hartë?

9 PË. E gjeta Pestovën. Mund ta gjej. Megjithatë unë fillova që
10 të vozisja makinën time në këtë vend, ndoshta 4-5 [sipas
11 përkthimit] metra nga Novosela tek kjo rruga e brendshme.
12 Ndërkohë që sa i takon Pestovës po mund ta caktoj këtu. Se dhe
13 fshati im është pranë Pestovës. E di ku është Pestova. Kjo
14 është pak a shumë pika nga ku fillova që të vozisja makinën
15 time.

16 Thashë 4 apo 5 metra larg vendit ku më kishin rrëmbyer.
17 Kur u ktheva në Zekiq, kjo është pika ku fillova të vozisja
18 makinën time.

19 PY. Rrugës që bëtë ju gjatë vozitjes tuaj a kaluat në Pestovë
20 më datë 9?

21 PË. Po.

22 PY. E vura re që keni shënuar numrin 3 ngjitur me Pestovën. A
23 patët mundësi që të identifikoni vendin e përafërt, a mundni
24 që të identifikoni vendin nga ku ikët nga Lada kur dolët nga
25 Lada, në çfarë vendi ka qenë këtu në qoftë se mund ta

1 identifikoni?

2 PË. Mendoj se ka qenë diku këtu.

3 PY. A mund të vendosni numrin 4 te ky vendi.

4 PY. Shumë faleminderit.

5 Z. BOYLE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a ju vende të
6 tjera për t'u identifikuar?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
8 çaktivizuar]

9 Edhe Kleçka u përmend disa herë. U përmend nga z.
10 Misetic. Ndoshta do ishte mirë që t'i kërkohet dëshmitarit që
11 ta identifikojë në hartë Kleçkën.

12 Z. BOYLE: [Përkthim] Sipas asaj çfarë na ka thënë në
13 dëshminë e tij ai tha që nuk e kujtonte mirë se ku ishte
14 Kleçka.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'ia
16 bëni këtë pyetje.

17 Z. BOYLE: [Përkthim] Ndoshta mund ta heqim nga ekrani
18 hartën se nuk na duhet për këtë pyetje apo?

19 PY. Z. Dëshmitar, a jeni në gjendje të identifikoni, të
20 tregoni në hartë se ku gjendet Kleçka, vendi me emrin Kleçkë?

21 PË. Nuk e di. Nuk e di me saktësi se ku është. Mund të jetë
22 diku në këtë zonën në rrugën drejt Pejës, në të majtë të
23 rrugës që të çon në Pejë. Nuk e di, se Kleçka është shumë larg
24 nga zona ime, nga aty ku kam jetuar unë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, mos

1 hamendësoni.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres.

3 Por a mund të kërkojë që të identifikojë Fushë-Kosovën në

4 hartë dëshmitari?

5 Z. BOYLE: [Përkthim] Nuk e kundërshtoj këtë pyetje.

6 PY. Z. Dëshmitar, a mund të shënoni në hartë se ku është

7 Fushë-Kosova?

8 PË. Këtu. Këtu është.

9 PY. A mund të vendosni numrin 5 këtu?

10 PË. Po, këtu është.

11 Z. BOYLE: [Përkthim] Ka ndonjë pyetje tjetër sa i takon

12 vendeve?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë

14 pyetje tjetër që palët duhet të bëjnë sa i takon vendeve?

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj që duhet të kërkoni

16 regjistrimin si provë materiale të kësaj harte.

17 Z. BOYLE: [Përkthim] Po. Faleminderit që më kujtuat.

18 Kërkoj që ky dokument të pranohet si provë materiale.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

20 SPOE00208166 pranohet me shënimet që bëri dëshmitari.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

22 harta e shënuar do të marrë të Zyrës Administrative si ERN

23 REG00978 dhe do i caktohet numri i provës materiale P701.

24 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Gjykatësi Barthe, ka disa pyetje.

2 Pyetje nga Trupi Gjykses:

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] faleminderit, Gjykatësi
4 Smith.

5 Mirëdita. Më shikoni? Edhe një herë. Mirëdita. Kam disa
6 pyetje të tjera për ju, Dëshmitar. Më herët sot, z. Misetic i
7 Mbrojtjes së Thaçit ju pyeti me faktin që kishit pirë alkool
8 atë ditë që ka ndodhur rasti që diskutuam sot më datën 9
9 shkurt 1999. A ju kujtohet që ju bënë pyetje lidhur me këtë,
10 Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju konfirmuat në fakt atë
13 çfarë kishit thënë në deklaratën e ZPS-së, që është prova
14 materiale 694.2, në faqen 10, rreshtat 1 deri në 6, që kishit
15 pirë tre apo katër gota raki sikurse e thatë dhe sot, a është
16 e saktë kjo?

17 A mund të më jepni një përgjigje, Dëshmitar?

18 PË. Po. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

20 Për një person që nuk e njeh mirë rakinë, që nuk është
21 mësuar që të pijë rakinë, a mund të na thoni se për sa sasi
22 rakie bëhet fjalë kur thua që kam pirë tre-katër gota? Bëhet
23 fjalë për një gotë të vogël, domethënë, tre-katër gota janë të
24 barabarta me një gotë vogël?

25 PË. Janë pak a shumë madhësia e kësaj gotës që kam këtu.

1 domethënë, bëhet fjalë për gota teke, gota të vogla ndoshta.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gotë e vogël?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres. A
4 mund të themi që keni pirë një teke raki, kështu?

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e di sesi e quani ju këto, po
6 janë gota që përdoren zakonisht për të pirë raki. Janë gota të
7 vogla rakie. Sesa mund të mbajë një gotë e tillë nuk di t'ju
8 them. Janë gota të vogla. Janë gota që përdoren për raki.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në qoftë se ju
10 kujtohet sot, në çfarë kohe e keni pirë gotën e fundit të
11 rakisë, domethënë, ka qenë në fillim apo në fund të vizitës
12 tek ajo kafeneja ku keni qenë në Miloshevë?

13 PË. Unë gotën e fundit e kam pirë mbase nga gjysmë ore deri
14 në 15 minuta përpara sesa të largohesha. Do ishte mbase më
15 mirë që të them rreth gjysmë ore para se të largohesha nga
16 kafeneja.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni ngrënë ndonjë gjë
18 përpara, gjatë ose pasi pitë rakinë te kafeneja?

19 PË. Po kisha ngrënë më përpara. Kisha shkuar në shtëpi. Kisha
20 ngrënë në shtëpi. Isha larguar nga shtëpia që të shkoja dhe të
21 takohesha me disa shokë. Kështu ka qenë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni ngrënë drekë në shtëpi?

23 PË. Po, po drekë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përsëri lidhur me pyetjen që
25 ju bëri avokati. Si jeni ndjerë kur u larguat, kur dolët nga

1 kafeneja ndërkohë që keni vozitur makinën? A kishit ndonjë
2 problem ju që të ecnit apo që të ngisnit makinën?

3 PË. Jo, jo, nuk kisha asnjë problem. Thjesht ndjeja pak
4 ndikim alkooli, po nuk kisha pikë problemi që të ecja ose të
5 vozisja makinën, thjesht mund të ndjeja pak reagim në trup.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po binte borë ndërkohë që po
7 vozisnit makinën ju?

8 PË. Jo, nuk po binte borë. Po kishte rënë borë më përpara. Në
9 atë çast nuk po binte borë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me fjalë të tjera, kishte
11 borë apo baltë në rrugë. apo jo?

12 PË. Kishte borë. Kishte borë në dy krahët e rrugës ndërkohë
13 që rruga vetë ishte e pastër nuk kishte borë. Asfalti nuk
14 kishte borë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Besoj që jua bëri këtë
16 pyetje z. Misetiç apo jo, po dua t'ju pyes dhe unë. Nuk ishte
17 problem për të parë rrugën?

18 PË. Jo. Në atë kohë jo.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kur keni qenë
20 te gepeku i makinës, makinës tuaj në Fiat dhe pastaj në
21 gepekun e Lada së bashku me këtë personin që ju besoni që ka
22 qenë Markovic, a keni pasë ndonjë problem fizik, domethënë, a
23 e keni pasë të vështirë që të merrnit frymë, mezi mbusheshit
24 me frymë, për shembull?

25 PË. Jo, jo, fare.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshiroj që të ndryshojmë
2 pak temë sot. nga ajo çfarë mendon ti sot, thuajse 25 vite
3 pasi ka ndodhur rasti në fjalë, çfarë mendon ti, cilat kanë
4 qenë arsytet e rrëmbimit tuaj siç i mendon gjërat sot?
5 PË. Nuk them dot gjë. Thjesht e di që ka pasur raste
6 rrëmbimesh edhe përpara sesa të rrëmbehesha unë dhe kanë
7 ndodhur raste rrëmbimesh edhe pasi u rrëmbeva unë. Janë kryer
8 dhe raste vrasjesh. Arsytet ishin për shkaqe etnike. Këto kanë
9 qenë arsytet. Përpara sesa më ndodhi ky rast mua, ka pasur
10 vrasje, ka pasur rrëmbime edhe pas rastit tim ka pasur raste
11 kur janë vrarë njerëz. Këto janë bërë për arsye etnike, për
12 shkaqe etnike. Shpresoj që më kuptoni këtë që po them.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mendoj që e kuptoj. Dhe kjo
14 është ajo çfarë keni thënë dhe në deklaratën për ZPS-në në
15 provën materiale P694.3, faqen 14, rreshtat 1 deri në 21, ku
16 ju thoni që u pyetët nga një burrë trup vogël apo shtat vogël,
17 që ju mendonit që ishte drejtuesi i grupit, i cili kishte armë
18 dhe ishte një person i milicisë në fshatin tuaj, A është e
19 saktë kjo? Dhe a ju kujtohet t'ia keni thënë këtë gjë
20 Prokurorit?

21 PË. Po, më kujtohet.

